



DORACAK PËR MËSIMDHËNËS

Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Financed
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe





DORACAK PËR MËSIMDHËNËS

Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor

SHTATOR, 2012

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)




Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë'. Përbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

Përmbajtja

Mirënjohje	07
Parathënie	09
Hyrje	13
Porosi mësimdhënësve	15

Njësia mësimore	Niveli	Titulli
Trashëgimia dhe diversiteti Fq. 16-19	Klasat 3-6	Çka është trashëgimia kulturore?
	Klasat 6-9	Elementet e trashëgimisë kulturore
Trashëgimia kulturore e prekshme Fq. 20-21	Klasat 3-9	Udhëtimi zbulues
Trashëgimia natyrore Fq. 22-25	Klasat 3-6	Shtatë mrekullitë natyrore në Kosovë
	Klasat 6-9	Shtatë mrekullitë natyrore në Kosovë
Trashëgimia jomateriale Fq. 26-29	Klasat 3-6	Enigma kulturore
	Klasat 6-9	Enigma e antropologut kulturor
Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore Fq. 30-33	Klasa 3	Arka e bashkësisë sonë
	Klasat 6-9	Artifaktet
Diversiteti: Identiteti jonë Fq. 34-37	Klasat 3-6	Kush jam unë?
	Klasat 6-9	Korniza jonë
Diversiteti: Perceptimet e ndryshme Fq. 38-41	Klasat 3-6	A po e shoh tërë fotografinë?
	Klasat 6-9	E njëjta kornizë nuk i përshtatet gjitha fotografive
Diversiteti: Respektimi dhe pranimi i ndryshimeve Fq. 42-49	Klasat 3-6	Bashkësia dhe pranimi
	Klasat 6-9	Ne të gjithë përkasim
Fjalori i termave Fq. 50-51		
Shtojcat Fq. 52-53		





Mirënjohje

Stafi i projektit PDKK shfrytëzon rastin t'i falënderojë e t'u shpreh mirënjohje një numri të individëve për përkushtimin e madh, pjesëmarrjen dhe rolet e rëndësishme në nxjerrjen e njësive mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor.

Së pari, stafi i projektit i falënderon veçanërisht mësimmshënësit dhe nxënësit nga 14 shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, për qasjen e tyre konstruktive dhe profesionale kundrejt projektit si dhe për kontributin e tyre të vlefshëm në hartimin e njësive mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor.

Krahas kësaj, stafi i projektit u është shumë mirënjohës ekspertëve të vet, znj. Jenny Otting dhe z. Veton Sylhasi, për instruksionet e tyre të çmueshme, drejtimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme përgjatë gjithë procesit, sugjerimet e tyre të çmuara dhe, përfundimisht, për hartimin e njësive mësimore të kursit për trashëgimi dhe diversitet.

Po ashtu falënderojmë znj. Besnike Rraci nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe z. Arbër Salihu nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për kontributin e tyre të rëndësishëm dhe për përkrahjen në hartimin e njësive mësimore.

Vlerësimi ynë i lartë u shkon poashtu prindërve të nxënësve nga 14 shkollat që morën pjesë në aktivitetet e projektit, dhe të cilët i sollën frymë pozitive dhe shtysë procesit.

Një falënderim shkon edhe për asistentin e komponentës së edukimit, Arif Muharremin, për koordinimin e këtij procesi, si dhe Julija Trichkovska për mbështetjen teknike rreth trashëgimisë kulturore.

Për fund, do të donim t'i falënderojmë të gjithë individët që dhanë mbështetje, ndanë njohuritë e tyre, udhëzuan dhe dhanë perspektivat e tyre duke kontribuar në arritjen e suksesshme të projektit.

Lista e shkollave pjesëmarrëse:

1. Bedri Gjinaj, Mitrovicë
2. Andon Zako Çajupi, Vushtrri
3. Fazli Grajçevci, Obiliq
4. Hysni Zajmi, Istog
5. Ismet Rraci, Klinë
6. Asdreni, Pejë
7. Edmond Hoxha, Junik
8. Isa Boletini, Deçan
9. Zekeria Rexha, Gjakovë
10. Abdyl Frashëri, Prizren
11. Gjon Serreçi, Klllokot
12. Idriz Seferi, Strezoc
13. Abaz Ajeti, Gjiilan
14. Selman Riza, Fushë Kosovë



Parathënie

Është thënë shpesh se fëmijët e vegjël mësojnë më së shpejti. Mendjet e tyre kureshtare gjurmojnë dhe pyesin për botën përreth; ata janë të gatshëm dhe të padurueshëm për t'u angazhuar. Duke u rritur, ata i bartin me vete shkathhtësitë, njohuritë dhe idetë që i kanë përvetësuar në moshën më të hershme. Ata i transmetojnë këto te të tjerët që takojnë dhe, më vonë, tek fëmijët e tyre. Prandaj, investimi në edukimin e hershëm është ndër mjetet më të fuqishme për të bërë ndryshimin pozitiv për të ardhmen.

Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Përkrahja për promovimin e diversitetit kulturor në Kosovë* (PDKK)" ka investuar kohë, shkathhtësi dhe resurse për të përkrahur edukimin e nxënësve të shkollave në Kosovë mbi temat e gjera të rëndësishme të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor. Ne kemi paraqitur një qasje e cila inkurajon pjesëmarrjen kur kemi disajnuar projektin dhe kemi siguruar ndikimin e tij përmes përfshirjes të drejtpërdrejtë aktive të nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve. Kjo ka çuar te publikimi i këtij doracaku për mësimitdhënës, që është një strukturë punuese e njëjësive mësimore, që prezanton nëpër klasa temat e trashëgimisë dhe diversitetit dhe rëndësinë e tyre në jetën e përditshme. Hapësira e dhënë komuniteteve në këtë proces është një mjet i fuqishëm për të komunikuar idetë dhe temat sa më gjerësisht që është e mundur. Procesi i transmetimit të mësimitdhënësit, përmes "mësimit të drejtpërdrejtë" praktik, të cilët pastaj do e transmetojnë atë në të njëjtën mënyrë të nxënësit, është një qasje e re në zhvillimin arsimor në rajon.

Ne shpresojmë se ndikimi i këtyre materialeve për mësimitdhënë do të rezultojë me një vetëdije dhe vlerësim të rritur për trashëgiminë kulturore të Kosovës. E njëjta metodologji e mësimitdhënies, po ashtu, mund të përdoret në një varg lëndësh, ku përfshirja aktive e nxënësve në procesin e studimit, logjikës dhe vënies në pyetje të ideve do të rrisë shkathhtësitë e mendimit kritik dhe zhvillimit personal. Një ndër sfidat më të mëdha në Kosovë në mbrojtjen e trashëgimisë, në të gjitha format e saj, është vetëdija aktuale relativisht e ulët rreth asaj se çka në të vërtetë e përbën trashëgiminë

dhe pse trashëgimia kulturore duhet të mbrohet. Si munden komunitetet t'u rezistojnë kërcënimeve ndaj trashëgimisë kulturore, që shkaktohen nga ndryshimet e shpejta në prirjet shoqërore, kulturore dhe demografike, dhe nga urbanizimi në rritje që shpesh nuk e njeh vlerën delikate - ndonjëherë vështirë të perceptueshme - të trashëgimisë. Të mësuarit e komuniteteve me praninë e trashëgimisë së pasur dhe të larmishme të Kosovës, si dhe të adresuarit se si ata mund të përkrahin këtë nga brenda, është një proces i vazhdueshëm.

Doracaku për mësimitdhënës mund të përdoret tash me nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta. Të 14 pilot shkollat dhe pjesëmarrësit që ishin përfshirë në krijimin e këtyre njëjësive, tashmë e kanë mirëpritur me energji dhe entuziazëm metodologjinë tonë dhe rezultatet e saja. Përmbytja e doracakut e përfshin trashëgiminë kulturore si pjesë bërthamë të ndjenjës së komunitetit për identitetin dhe vendin në botë, si dhe ndihmon të përçojë vlerën e asaj që mund të mos ketë qenë pranuar lehtësisht si e rëndësishme kritike për shoqërinë.


Këshilli i Evropës për një kohë të gjatë ka qenë i përkushtuar ndaj idesë se edukimi është mjet themelor për të siguruar zhvillim pozitiv shoqëror, kulturor dhe ekonomik, dhe do të vazhdojë të përkrahë PDKK-në në monitorimin dhe zbatimin e këtij projekti të rëndësishëm dhe novator për trashëgiminë dhe diversitetin.

I inkurajoj mësimitdhënësit të shikojnë me kujdes këto materiale, dhe t'i përdorin e t'i adaptojnë ato me zgjuarsia dhe kreativitet, si një kontribut i rëndësishëm në ndërtimin e mirëkuptimit ndërmjet të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.

Robert Palmer

Drejtor i qeverisjes demokratike,
kulturës dhe diversitetit
Këshilli i Evropës

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opininionin e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Parathënie

Trashëgimia kulturore në Evropë është gjëresisht e njohur si një mjet i identitetit kulturor. Mbrojtja e trashëgimisë sonë të përbashkët dhe promovimi i diversitetit kulturor janë po ashtu instrumente shumë të rëndësishme për t'i sjellë më afër komunitetet e ndryshme si dhe për të zgjëruar dialogun mes kulturave të ndryshme.

Se sa dinë njerëzit për trashëgiminë kulturore, varet shumë nga ajo ç'është bërë për ta promovuar atë, e po ashtu edhe nga aftësia e evropianëve për tu familjarizuar dhe vlerësuar kulturën e vet si dhe atë të komuniteteve tjera.

Kjo është arsyeja pse njëri nga objektivat kryesorë të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës "Përkrahja për promovimin e diversitetit kulturor në Kosovë" është të shtohet vetëdija e nxënësve, studentëve dhe popullatës së përgjithshme mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore si një e mirë e përbashkët, pavarësisht përkatësisë etnike apo religjioze. Nxënësit sot janë popullata e rritur e Kosovës nesër, dhe ne duam që kjo popullatë të vlerësojë diversitetin kulturor si një mundësi për dialog, të konsiderojë trashëgiminë kulturore si pronë të përbashkët e cila kërkon mbrojtje, dhe si një mjet për pajtim dhe për të parandaluar konfliktin, më tepër se sa për ta shkaktuar atë.

Ky doracak për mësime është hartuar në mënyrë që t'u jepet mësimeve një mjet për të shtuar këtë vetëdije dhe për të rritur edukimin qytetar, duke nxitur përfshirjen aktive dhe të menduarit kritik. Gjatë zhvillimit dhe konceptimit, nxënësit, prindërit, akademikët dhe palët tjera relevante janë përfshirë dhe kanë pasur mundësinë që të sjellin përvojat dhe vizionet e tyre të ndryshme kulturore.

Ruajtja dhe promovimi i diversitetit kulturor janë në mesin e parimeve themelore të Bashkimit Evropian dhe parim udhëheqës për bashkëpunimin tonë me Kosovën. Duke përkrahur të kuptuarit më të mirë të rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore, unë shpresoj se doracaku për mësime do të kontribuojë në forcimin e dialogut midis komuniteteve të ndryshme dhe do të nxisë pajtimin në mënyrë afatgjatë.

Samuel Žbogar

Udhëheqës i zyrës së BE-së/Përfaqësues special i BE-së



Hyrje

Prej ditës së parë të projektit të përbashkët të BE/KE “Përkrahja në promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK)”, një ndër parimet kryesore të metodologjisë ka qenë të zhvillohet “kultura e praktikës së komunitetit”. Përmes kësaj qasjeje, është nxitur dhe përkrahur përfshirja aktive e komunitetit në aktivitetet e PDKK-së. Komponenti i edukimit dhe vetëdijesimit ka qenë një shembull i mirë i zbatimit të këtij parimi, ku përfshirja e nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve nga 14 shkollat anembanë Kosovës ishte pjesë vendimtare në nxjerrjen e këtij doracakut për mësimitdhënës.

Bazuar në një vlerësim që është bërë në vitin 2010, burimet mësimore për trashëgiminë dhe diversitetin ishin identifikuar si një nevojë për lëndën e edukatës qytetare. U zhvillua një qasje gjithëpërfshirëse, qasje në edukim e drejtuar nga poshtë lartë, ku nxënësit do të përfitonin një përvojë të drejtpërdrejtë dhe do të kishin fjalën e tyre në edukimin e tyre. Ndërsa tema fokusohet në trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor, metodologjia vlen të shqyrtohet, sepse mund të shërbejë si model mësimitdhënies për lëndët e tjera.

Doracakut për mësimitdhënës është përgatitur si një kurs shtesë në trashëgimi dhe diversitet për shkollat fillore e të mesme të ulëta (klasat 3 - 9), me qëllim që të ofrojë resurse për mësimitdhënësit në këtë fushë. Procesi i stërzgjatit i përgatitjes së doracakut ishte qenësor për përfshirjen e më shumë se 250 individëve, ndër të cilët nxënës, prindër, mësimitdhënës, administratorë shkollash, zyrtarë komunalë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të institucioneve qendrore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëhequr nga stafi i projektit, si dhe nga ekspertit lokal e ekspertja ndërkombëtare, një numër aktivitetesh zunë vend gjatë përgatitjes së këtij doracakut ku përfshihen vizitat nëpër lokalitete, sesionet e dialogut pas vizitave, grupet punuese, punëtoritë në Kosovë dhe udhëtimin studimor në

Zvicër. Drafti i doracakut u testua me mësimitdhënësit nga gjithë Kosova në një punëtori në Prishtinë, në fund të vitit 2011.

Në PDKK ne besojmë se ky doracak mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e praktikave arsimore, si me produktin e krijuar ashtu edhe me vetë procesin. Orientimi dhe përkrahja jonë për vendosjen e aktivitetit edukativ në përvojën e drejtpërdrejtë të pjesëmarrësve hap një seri mundësish për mënyrën se si edukatorët në sistemin formal dhe joformal mund t'i qasen profesionit. Mundësia e krijimit të mënyrave të reja për t'ju qasur edukimit me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, e cila siç është dëshmuar në këtë rast, nuk ka ndodhur më parë në Kosovë, ka prodhuar një interesim dhe entuziazëm të mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit.


Ne besojmë se formimi i vetëdijes kritike, që nxitet përmes përfshirjes aktive të nxënësve, bazuar në të mësuarit përmes përvojës, u mundëson njerëzve të vënë në pyetje idetë dhe perspektivat e dhëna, ashtu sikurse edhe marrëdhëniet e tyre me rrethinën, për të kuptuar më mirë botën e tyre. Shkëmbimi aktiv në mes mësimitdhënësve dhe nxënësve, ku të dyja palët mësojnë, parashtrajnë pyetje dhe reflektojnë, është qenësore në krijimin e shoqërisë demokratike.

Doracakut, i përbërë nga 8 njësi mësimore, u ofron mësimitdhënësve mjetet praktike dhe një terren dinamik për angazhim aktiv të nxënësve në periudhën prej 40 minutash të orës mësimore, që veçanërisht është disenjuar në përputhje me ritmin e arsimit në Kosovë.

Shpresojmë se ky doracak do të luajë një rol konstruktiv në këtë proces dhe e mbush boshllëkun në kurrikulumin e lëndës së edukatës qytetare, duke frymëzuar në të njëjtën kohë zhvillimin e kurseve të ngjashme në një të ardhme të afërt.

Hakan Shearer Demir

Udhëheqësi i ekipit të PCDK-së



Porosi mësimdhënësve

Njësitë mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor, të prezantuara në këtë doracak, janë hartuar me qëllim të paraqitjes së temave të përgjithshme që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor. Është menduar që doracaku të përdoret si material shtesë brenda lëndës së edukatës qytetare, për të siguruar të kuptuarit themelor për disa nga çështjet dhe për të filluar të menduarit e bashkëbisedimin për temën e kulturës. Temat dhe rezultatet e të nxënësve janë menduar të përdoren si pikë fillestare dhe udhërrëfyes për mësimdhënësit. Prandaj, ju ftojmë të zhvilloni më tej diskutime dhe aktivitete, përtej asaj që është përmendur në doracak.

Janë tetë njësi mësimore të ndryshme që adresojnë trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor. Secila njësi e ka fokusin tematik dhe përmban rezultatet e të nxënësve, informacionin paraprak dhe aktivitetet për klasat 3-6 dhe 6-9. Pasi të vlerësojë nivelin e nxënësve, mësimdhënësi mund të zgjedhë njësinë që është e përshtatshme për atë nivel. Njësitë janë disajnuar për një orë mësimore me 40 minuta. Sidoqoftë, aktivitetet mund të adaptohen e të ndryshohen për t'u përdorur nëpër disa orë mësimore. Aktivitetet për secilën njësi mësimore janë treguar me hollësi në procedurë dhe në parim janë tri pjesë për aktivitetet e njësisë: aktiviteti hyrës, aktiviteti kryesor

dhe reflektimi. Kjo strukturë i ofron mësimdhënësit një aktivitet për të paraqitur temën mësimore, ndërsa pastaj mësimdhënësi dhe nxënësit shqyrtojnë idetë/temat më në thellësi gjatë aktivitetit kryesor. Përfundimisht, gjatë fazës së reflektimit, nxënësit kanë mundësinë të ndajnë me të tjerët atë që mësuuan dhe ndien. Aktivitetet pasuese dhe variantet e aktiviteteve janë dhënë për rastet kur mësimdhënësi dëshiron të shqyrtojë më tej konceptet apo të adaptojë aktivitetet për secilën njësi.

Ne jemi të vetëdijshëm se çështjet që rrethojnë trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor janë të shumta dhe komplekse, prandaj nuk është menduar që këto njësi mësimore të sigurojnë të gjitha përgjigjet dhe të adresojnë të gjitha interesimet në lidhje me këto çështje. Në vend të kësaj, qëllimi i doracakut është që t'u ofrojë mësimdhënësve aktivitete të të nxënësve në bashkëpunim si dhe praktika reflektuese që nxisin interesimin e nxënësve në të mësuarit e këtyre temave.

Sinqerisht shpresojmë se ju do t'i konsideroni këto njësi mësimore të dobishme për të zhvilluar kompetencën qytetare të nxënësve tuaj!

Përhëndetjet më të ngrohta!

Jenny Otting
Veton Sylhasi

Trashëgimia dhe diversiteti

TITULLI: ÇKA ËSHTË TRASHËGIMIA KULTURORE?

NIVELI: KLASAT 3-6

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Definojnë trashëgiminë kulturore;
- Përshkruajnë trashëgiminë kulturore materiale (të prekshme) dhe jomateriale (të paprekshme);
- Arsyetojnë se si trashëgimia kulturore, për nga natyra, është komplekse dhe e shumëllojshme dhe që të gjitha llojet e trashëgimisë njerëzore e demonstrojnë dhe e vënë në spikamë këtë llojllojshmëri;
- Krahasojnë dhe ballafaqojnë kulturën e tyre me kulturat e fëmijëve të tjerë në të gjithë botën.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

Harta e botës, e ndarë në pjesë – enigma e botës (Shtojca 1.1)

Foto – përdor foto me elemente të trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme. (Shtojca 1.2) Laptop dhe projektor (jo medoemos)

INFORMACIONI PARAPRAK

Qëllimi i kësaj njësie është të ndihmojë nxënësit që të kuptojnë konceptin e kulturës duke shikuar në kulturat gjithandej nëpër botë. Studentëve do t'ju paraqiten foto apo video të kulturave tjera, ashtu që ata të identifikojnë elemente të ndryshme të kulturës, si dhe të mësojnë se si kulturat kontribuojnë në krijimin e një trashëgimie të pasur dhe të bukur botërore.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Copëzat e botës

Ndani nxënësit në grupe prej katër apo pesë vetave. Jepni secilit grup të njëjtën foto të hartës së botës, të prerë në copa (Shtojca 1.1). Të gjitha grupet duhet të kenë foton të prerë në numrin e njëjtë të copave. Tregojni nxënësve që kur të jepni shenjën, ata duhet të fillojnë të zgjidhin enigmën. Grupi që zgjidh enigmën i pari, fiton.

Aktiviteti kryesor: Kultura e prekshme dhe e paprekshme

Filloni duke shpjeguar se ideja e kulturës është e vështirë të definohet. Në fakt, nuk ekziston ndonjë



SHITORE MASKASH, SHKODËR, SHQIPËRI

pajtim për një definicion të vetëm të kulturës. Megjithatë, trashëgimia kulturore është e definuar qartë, por interpretohet në mënyra të ndryshme. U thoni nxënësve se do të shqyrtoni së bashku idenë e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

- Pyesni nxënësit se cilat janë tiparet (elementet) e kulturës dhe shkruani përgjigjet e tyre në tabelë. Nëse ka nevojë, ndihmoni ata të gjejnë disa tipare. Sqarojuni nxënësve idenë e karakteristikave apo tipareve njerëzore që mund të shihen e preken (të prekshme apo materiale) dhe atyre që nuk janë të këtila (të paprekshme apo jo materiale), e që ndër lidhen me kulturën dhe trashëgiminë kulturore.

- Analizoni tiparet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore përmes disa fotove që do t'i paraqisni (projektoni) në mur (nëse nuk keni projektor, përcilluni nxënësve fotot e shtypura. Mund të përdorni fotot nga shtojca 1.2). Pasi të shfaqet një foto, kërkoni nga nxënësit të identifikojnë elementet e prekshme dhe, nëse është e mundur edhe elementet e paprekshme të kulturës. Pastaj paraqitni foton tjetër dhe kërkoni të njëjtën gjë. Ndihmoni nxënësit të vijnë te këso përfundimesh:

- Elemente të prekshme të kulturës: artet (pikturat, skulpturat, objektet e artifaktet që ju takojnë gjeneratave të mëparshme, librat e rralla, etj.), ndërtesat/arkitektura (fortifikatat, urat, etj.)

- Elementet e paprekshme të kulturës: besimet, normat, rregullat, standardet shoqërore, vlerat.

Reflektimi

Hapni diskutimin lidhur me kulturën. Pyesni nxënësit:



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Nëse jeni të lidhur me internet dhe keni katër apo pesë kompjuterë apo laptopa, mund të organizoni lojën duke përdorur ueb faqen
 - <http://www.coedu.usf.edu/culture/Activities/JigSaw/World.html>
- Mund të prezantoni video të shkurtra të kulturave tjera, në vend të fotografive

Aktivitetet pasuese:

- Nxënësit mund t'iu shkruajnë letër njerëzve nga kulturat tjera, duke u treguar për kulturën e vet.
- Nxënësit mund të përgatisin një projekt artistik ku do të shfaqnin diversitetin kulturor të botës. Mund të përdorni një analogji të kaleidoskopit për të diskutuar dhe menduar për llojllojshmërinë e trashëgimisë kulturore botërore. Ata mund të prejné dhe të bashkojnë fotot që përfaqësojnë kultura të ndryshme dhe t'i vendosin së bashku në formën e një kaleidoskopi. U thoni nxënësve se ata do të krijojnë një pjesë të fotografisë së kaleidoskopit. Secili nxënës duhet të prejé një formë të trekëndëshit me kokë teposhtë. Pastaj kërkoni atyre të ngjeshin fotografitë apo vizatojnë kultura të ndryshme në pjesën e tyre trekëndëshe të kaleidoskopit. Pasi që secili nxënës të ketë dekoruar pjesën e vet të kaleidoskopit, kërkoni atyre të bashkojnë pjesët e veta për të formuar fotografinë bazë të kaleidoskopit (8-9 pjesë kompletojnë fotografinë e tërë). Si klasë, diskutoni se si kaleidoskopi mund të jetë një analogji e trashëgimisë botërore. U shfaquni nxënësve fotografi të kulturave të ndryshme dhe vëni në spikamë llojllojshmërinë që ata shohin. Pyesni pse kjo llojllojshmëri është e rëndësishme për botën.

- A ishin kulturat të ndryshme nga njëra-tjetra? Sa të ndryshme ishin ato?

- A mund të gjeni ngjashmëri në mes kulturave të ndryshme? Mundohuni të gjeni dy apo tri elemente që këto kultura i kanë të përbashkëta me kulturën në Kosovë (në këtë moment mund të projektioni edhe një herë fotot me radhë).

- A është një kulturë më e mirë se një tjetër? Pse/ pse jo?

- A pajtoheni me pohimin se larmia (diversiteti) e kulturave e bën botën më të pasur dhe se elementet e ngjashme të kulturave na japin ndjenjën sikur i përkasim gjithë racës njerëzore?

Ktheshuni te pjesa filltare e diskutimit dhe mundohuni të vini te një definicioni i përbashkët i klasës mbi kulturën. Kërkoni nga nxënësit të punojnë në grupe të vogla, duke shkruar një apo dy fjali apo fjalë të thjeshta që përshkruajnë kulturën. Pastaj, shkruani definicionet apo listat e fjalëve të secilit grup në tabelë. Si klasë, krijoni një definicion të pranueshëm për të gjithë mbi kulturën, duke përdorur fjalët dhe fjalitë e zgjedhura nga nxënësit. Shembujt mund të përfshijnë:

- Mënyra se si një grup i veçantë i njerëzve jeton, si i perceptojnë ata situatat dhe si sillen si grup;

- Mënyrat se si një grup apo shoqëri përshtatet në një mjedis;

- Një grumbull i traditave (siç janë ushqimet, vallëzimet e muzika), dijeve dhe besimeve të përbashkëta të një grupi njerëzish që kalohen prej një gjenerate në tjetrën.



Burime shtesë:

- Ueb faqja e "The National Geographic" ofron foto dhe video mbi kulturat e ndryshme:
<http://www.nationalgeographic.com/>

Trashëgimia dhe diversiteti

TITULLI: ELEMENTET E TRASHËGIMISË KULTURORE

NIVELI: KLASAT 6 - 9

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë dhe përshkruajnë elementet e prekshme (materiale) dhe të paprekshme (jo materiale) të kulturës;

- Arsyejnë se si trashëgimia kulturore, për nga natyra, është e shumëllojshme dhe se të gjitha llojet e trashëgimisë njerëzore e demonstrojnë dhe e vënë në spikamë këtë llojllojshmëri;

- Krahasojnë dhe të ballafaqojnë kulturën e tyre me kulturën e fëmijëve tjerë rreth botës;

- Shpjegojnë se si elementet e paprekshme të kulturës ndikojnë mbi elementet e prekshme të saj.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Një hartë e botës, e madhe
- Kopje të fotografisë së një akullnajë për secilin nxënës (shtojca 1.3)
- Kopje të fletës së punës "Elementet e kulturës" (shtojca 1.4)

INFORMACIONI PARAPRAK

Qëllimi i kësaj njësie është të ndihmojë nxënësit që të kuptojnë konceptin e kulturës duke i parë kulturat gjithandej nëpër botë. Nxënësit do t'i shkojnë procesit të vënies në hartë të kulturave të ndryshme, duke dhënë ide për vendet e ndryshme apo për karakteristikat e këtyre vendeve. Ata do të hulumtojnë aspektet e prekshme (materiale) dhe të paprekshme (jo materiale) të kulturës dhe ndikimin mes tyre, duke përdorur analogjinë e akullnajës.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Idetë për botën

- Ju thoni nxënësve se si klasë do të hulumtojnë botën në mënyrë më të hollësishme, duke u munduar të kuptojnë se si njerëzit në pjesë të ndryshme të botës jetojnë.

- Paraqitni një hartë të madhe të botës. Ofroni për nxënësit letra me ngjitës dhe lapsa. Kërkojuni atyre të mendojnë dhe të shkruajnë nëpër letra idetë e tyre për

vendet tjera nëpër botë, ose karakteristikat e ndryshme të këtyre vendeve. Thoni se nuk do të ketë përgjigje të sakta apo të gabuara.

- Kërkojuni nxënësve të formojnë grupe të vogla dhe të diskutojnë për çka kanë shkruar. Kërkonit që nëpër grupe të kombinojnë dhe t'i konsolidojnë idetë e tyre nëpër letra.

- Pastaj, kërkojuni secilit grup që të vendos letrat me ngjitës në hartë dhe të shpjegojë idetë e tyre.

- Lëreni hartën në një vend të dukshëm.

Aktiviteti kryesor: Akullnaja kulturore

- Filloni duke shpjeguar se është vështirë të definohet ideja e kulturës. Në fakt, nuk ekziston pajtim për një definicion të vetëm të kulturës. Rikujtojuni nxënësve se secili ka një kulturë dhe ajo formësohet në varësi se si e shohim botën, shfrytëzuar dhe të tjerët.

- Shpjegoni kulturën duke shfrytëzuar analogjinë e ajsbergut. Vizatoni një akullnajë në tabelë dhe kërkojuni nxënësve të kopjojnë atë në një fletë fletoreje (mund t'i referohesh shtojcës 1.3). Theksoni se vetëm 1/8 e një akullnajë është e dukshme mbi sipërfaqe të ujit; pjesa tjetër është nën të. Kultura është mjaft e ngjashme me akullnajën. Ajo i ka disa aspekte të cilat janë të dukshme dhe shumë të tjera që vetëm mund të supozohen apo të mësohen derisa zgjerohet njohuritë për kulturën. Sikur edhe te ajsbergu, pjesa e dukshme e kulturës është vetëm një pjesë e vogël e një tërësie dukshme më të madhe. Pyesni nxënësit nëse mund të japin ndonjë shembull. Nëse jo, përmendni ju ndonjë, p.sh. vlerat nuk mund të vëzhgohet drejtpërdrejt; adetet e festave janë të dukshme.

- Më tutje, u shpërndani nxënësve fletën e punës "Elementet e kulturës" (shtojca 1.4). Rishqyrtoni me nxënësit se e gjithë përmbajtja e listuar paraqet elemente të kulturës. Në grupe, kërkojuni atyre të shqyrtojnë elementet një nga një dhe të vendosin për secilin element nëse e ka vendin mbi sipërfaqe (është i prekshëm) apo nën sipërfaqe (është i paprekshëm). Tregojuni se janë edhe dy fusha të zbrazëta për t'i plotësuar me elemente të reja që ata i konsiderojnë të rëndësishme.

- Si klasë, shkoni nëpër secilin element të kulturës dhe pyesni grupet ku i kanë vendosur këto elemente në akullnajë – nën apo mbi sipërfaqe. Shkruani përgjigjet e grupeve në tabelë.

- Diskutoni mbi rezultatet e punës së tyre. Kushtoni vëmendje të veçantë ndonjë elementi që ka dalë edhe si i prekshëm; edhe si i paprekshëm. Kjo tregon se grupet e ndryshme kanë mendime të ndryshme për të njëjtin element. Mundohuni që si klasë të vini te të kuptuarit e përbashkët të këtij elementi.



KULLË, KOSOVË PERËNDIMORE (DETAIL)



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Kërkojuni nxënësve që të shkruajnë një dialog lidhur me një bashkëbisedim që do të ndodhte në mes tyre dhe njerëzve nga një kulturë tjetër. Ata duhet të paramendojnë se po i shpjegojnë kulturën njëri-tjetrit. Pastaj, kërkoju nxënësve që dialogun ta shndërrojnë në një dramë dhe ta luajnë.

- Nxënësit mund të merren me kulturën duke bërë një tabelë krahasuese. Kërkoni nga ata që nga gazetat e interneti (ose mund të shfrytëzojnë fotografitë e këtij udhëzuesi nga shtojca 1.2) të shikojnë fotografitë që paraqesin kultura të ndryshme. Thuaju nxënësve të zgjedhin dy foto që paraqesin të njëjtin aspekt të kulturës (p.sh. dy foto që pasqyrojnë dy forma të ndryshme të vallëzimit, stile të shtëpive, apo ceremoni). Kërkoju nxënësve të shkruajnë një shembull të këtij aspekti të kulturës nga Kosova. Ata mund të prezantojnë këto aspekte të kulturës në tabelën si më poshtë:

Foto 1	Foto 2	Kosova

- Nxënësve në grupe të vogla u jepni detyrë që të gjurmojnë për kultura tjera nga ajo e tyre dhe të përgatisin një prezantim për këto kultura.

- Kërkojuni nxënësve të reflektojnë për citatin më poshtë dhe t'i shkruajnë përgjigje Gandit:

“Unë nuk dua që shtëpia ime të jetë e murosur në të gjitha anët dhe dritaret e mia të jenë të mbyllura. Unë dua që kultura e të gjitha vendeve të fryjë sa më lirshëm në shtëpinë time. Por refuzoj që të shkulem nga vendi nga ana e kujtdo.”

—MAHATMA GANDHI,
filozof dhe burrshtetas
indian (1869-1948)

Reflektimi

Hapni diskutimin me nxënësit duke shtruar pyetjet si këto:

- A është kultura e thjeshtë apo komplekse? Çfarë na tregon kjo?
- A janë elementet e ndryshme të kulturës, të ndërlidhura? Si?
- Si ndikojnë aspektet jo materiale të kulturës në ato materiale?

Lidhni diskutimin me aktivitetin përgatitor:

- Ju lutem, shikoni edhe një herë në hartë për të dalluar gjëra që janë karakteristike për rajone të caktuara të botës Çka ju bie ndër mend tash?
- Cilat karakteristika janë unike për këto vende? Sa të ndryshme janë këto nga kultura tuaj?
- Cilat janë përfitimet dhe sfidat nga një botë me elemente kulturore të llojllojshme?
- A mund të gjeni ngjashmëri në mes të kulturave në hartë? Cilat janë disa gjëra të shkruara nëpër letra, që janë të ngjashme me kulturën tuaj? A mund të jepni shembuj tjerë që nuk janë në hartë?
- A pajtoheni se diversiteti (llojllojshmëria) i kulturave e bën botën më të pasur dhe se elementet e përbashkëta të kulturës na japin ndjenjën se i përkasim racës njerëzore si tërësi?

Si përfundim, provoni të krijoni një definicion të përbashkët të kulturës. Kërkojuni nxënësve të punojnë në grupe të vogla, për të shkruar një apo dy fjali apo fjalë të thjeshta që përshkruajnë kulturën. Pastaj, shkruani definicionin apo listën e fjalëve të secilit grup në tabelë. Si klasë krijoni një përkufizim të përbashkët, duke shfrytëzuar fjalët apo fjalitë e zgjedhura nga nxënësit. Shembujt mund të përfshijnë:

- Mënyra se si një grup i veçantë i njerëzve jeton, si i perceptojnë ata situatat dhe si sillen si grup;
- Mënyrat se si një grup apo shoqëri përshtatet në një mjedis;
- Një grumbull i traditave (siç janë ushqimet, vallëzimet e muzika), dijeve dhe besimeve të përbashkëta të një grupi njerëzish që kalohen prej një gjenerate në tjetrën.

Trashëgimia kulturore e prekshme

TITULLI: UDHËTIMI ZBULUES

NIVELI: KLASAT 3 – 9

KOHA: 40 MINUTA

FOTOGRAFITË: KULLË NË FSHATIN DRENOÇ (DETAL); MANASTIRI I SHEN ARHANGJELIT NË PRIZREN (DETAL); MANASTIRI I GRAÇANICES; PAJME NGA SIENA, ITALI; URË E GURIT NË GJAKOVË (DETAL).

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Japin definicionin e trashëgimisë kulturore materiale (të prekshme);
- Identifikojnë vendet e trashëgimisë kulturore të prekshme në Kosovë;
- Përshkruajnë disa detale apo aspekte të këtyre vendeve në Kosovë;
- Gjejnë në hartë ku janë këto vende.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

Nëse loja luhet përmes kompjuterëve, duhen materialet në vijim:

- Një hartë e madhe e Kosovës në klasë;
- Loja kompjuterike e disenjuar;
- Kabineti me kompjuterë;
- Flamujt prej letre.

Nëse kompjuterët nuk janë në dispozicion, në klasë mund të luhet një lojë duke përdorur materialet në vijim:

- Kopje të disa pyetjeve/përgjigjeve nga loja kompjuterike, të përcjella me fotografitë që lidhen me to;

- Një hartë e madhe e Kosovës në klasë;
- Harta të Kosovës për secilin ekip të nxënësve;
- "Kartolinat" e punuara.

Në të dyja modalitetet, duhet të zgjidhni nivelin e përshtatshëm të vështirësisë së lojës, varësisht nga mosha e nxënësve. Po ashtu mund të organizoni lojën individualisht apo në ekupe. Përgatitni flamujt prej letre para se të filloni lojën. Në modalitetin e lojës në klasë, përgatitni edhe "kartolinat" e punuara, po ashtu.

INFORMACIONI PARAPRAK

Në këtë njësi shfrytëzohet loja "Trivia" për t'ju treguar nxënësve vende të ndryshme të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe për t'i mësuar ata për këto



vende përmes zbatimjes dhe ndërveprimit. Loja "Trivia" mund të luhet përmes lojës kompjuterike që i është bashkëlidhur këtij doracak, ose si një aktivitet klasor pa përdorimin e teknologjisë. Në të dyja variantet, nxënësit duhet t'ju përgjigjen drejt pyetjeve, në mënyrë që të përfundojnë udhëtimin zbulues.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Ku do të shkonit?

- Hapni diskutimin duke i pyetur nxënësit për vendin që do të donin ta vizitonin në Kosovë dhe pse do të donin të bënin këtë.

- Paraqituni nxënësve idenë e organizimit të një udhëtimi nëpër Kosovë për të mësuar për vendet e trashëgimisë kulturore, duke iu sugjeruar të shikojnë në hartën e madhe të Kosovës në klasë.

- Pyesni nxënësit nëse dinë për ndonjë vend të trashëgimisë dhe të identifikojnë atë në hartë.

- Si klasë, definoni termin "trashëgimi", "trashëgimi kulturore" dhe "trashëgimi kulturore materiale".

Aktiviteti kryesor: Udhëtimi i zbulimit

Varianti i lojës kompjuterike:

- Jepuni nxënësve udhëzimet për lojën në kompjuter. Ata duhet të përfundojnë udhëtimin e tyre nëpër Kosovë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve. Për secilën përgjigje të saktë ata do të marrin kartolinën nga vendi për të cilin bëhet fjalë. Kur të marrin të gjitha kartolinat, ata e përfundojnë udhëtimin e tyre. Me këtë rast, ata duhet të ngrenë flamurin prej letre.

- Vëzhgoni përparimin e lojtarëve në lojë dhe ofroni përkrahje për individët apo ekipet që kanë vështirësi.

- Kur të gjithë të kenë ngritur flamujt e tyre, përfundoje lojën duke i uruar për arritjen e qëllimit.



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Mund të ketë shumë variacione që mund t'i bëhen lojës brenda klasës. Bëhuni kreativë dhe adaptoni detalet e lojës ashtu që më së miri t'iu përshtaten nxënësve tuaj.

- Nëse i ndani fëmijët në grupe, keni kujdes për balancën mes grupeve, në mënyrë që të ushqeni të nxëniet në bashkëpunimin.

Aktivitetet pasuese:

- Kërkojuni nxënësve të përgatisin një prezantim për njërin nga vendet e trashëgimisë kulturore që u përmend në lojë.

- Sugjerojuni nxënësve të planifikojnë një udhëtim nëpër Kosovë. Kërkojuni atyre të shkruajnë itinerarin e udhëtimit të tyre, duke përmendur vendet e trashëgimisë që do t'i vizitojnë dhe duke cekur arsyet pse duan ta vizitojnë secilin vend.

- Nëse është e mundur, vizitoni një vend të trashëgimisë kulturore afër shkollës suaj.

Burime shtesë:

Ueb faqet e mëposhtme mund të jenë të dobishme për të mësuar më shumë rreth trashëgimisë së prekshme kulturore:

- http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/kosovo/default_en.asp

- <http://chwbkosovo.org/>

- <http://www.visitkosovo.org/>

- <http://www.unesco.org/new/en/unesco/partners-donors/the-actions/culture/safeguard-the-cultural-heritage-in-kosovo/>

Varianti i lojës në klasë:

- Ndani nxënësit në epike prej 3-5 lojtarëve. Jepuni secilit grup nga një hartë të Kosovës

- Caktoni një asistent nga radhët e nxënësve, për të ndihmuar në numërimin e përgjigjeve të sakta dhe për t'i paraqitur ato në tabelën e rezultateve.

- Jepuni nxënësve udhëzimet në vijim për lojën: nxënësit duhet të përfundojnë udhëtimin e tyre nëpër Kosovë duke iu përgjigjur saktë pyetjeve. Për secilën përgjigje të saktë ata do të marrin një "kartolinë" që është punë dore. Loja luhet në faza apo rrethe. Secili ekip do të ketë të njëjtën pyetje në të njëjtën fazë apo rreth. Të gjitha ekipet do të kenë mundësinë të shkruajnë përgjigjen dhe pastaj përgjigjet grumbullohen. Mësimdhënësi do të zbulojë përgjigjen e saktë. Ekipi që merr më së shumti kartolina deri në fund të lojës, do të jetë ekipi fitues.

- Udhëhiqni lojën duke dhënë pyetjet, duke grumbulluar përgjigjet dhe duke nxjerrë rezultatet pas secilit rreth, për të përcaktuar fituesin në fund.

Reflektimi

Shtrojuni nxënësve këso pyetjesh:

- A ju pëlqeu loja?

- Çka mësuar prej saj?

- Cilat vende të trashëgimisë materiale i keni ditur që më parë dhe cilat i keni zbuluar?

- Çka paraqet trashëgimia jonë materiale kulturore?

- Si mund të hulumtojmë më thellësisht për vendet e trashëgimisë materiale kulturore?

- Pyetja e fundit mund t'ju drejtojë te aktivitetet pasuese.

Trashëgimia natyrore

TITULLI: SHTATË MREKULLITË

NATYRORE NË KOSOVË

NIVELI: KLASAT 3 – 6

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë vende të rëndësishme të trashëgimisë natyrore në Kosovë;
- Tregojnë territorin dhe burimet e vendeve të trashëgimisë natyrore të gjetura brenda Kosovës;
- Përshkruajnë rëndësinë e vendeve të trashëgimisë natyrore.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Kopjet e fotoalbumit të zbrazët për secilin grup (shtojca 3.1);
- Grumbulli i fotografive të mrekullive të reja të botës (shtojca 3.2);
- Grumbulli i fotografive të mrekullive natyrore në Kosovë për secilin grup + një për punë plenare (shtojca 3.3);
- Një hartë e madhe e Kosovës në klasë;
- Gërshërë dhe ngjites.

INFORMACIONI PARAPRAK

Kjo njësi shfrytëzon një aktivitet që mbështetet në konceptin e shtatë mrekullive antike të botës. Disa organizata kanë dalë me listën e shtatë mrekullive natyrore të botës. Përpjekja e fundit ka qenë që të krijohet një listë e shtatë mrekullive natyrore në bazë të votimit të përgjithshëm prej 2007- 2011. Lista është shpallur më 11.11.2011 dhe përfshin vendet në vijim:

1. Pyjet tropikale të Amazonës
2. Gjiri Halong
3. Ujëvarat Iguazu
4. Ishulli Jeju
5. Parku nacional Komodo
6. Lumi nëntokësor në Portoprincesa
7. Mali rrafshnaltë në Kejptaun

Ashtu siç këto vende janë të rëndësishme dhe të njohura në botë, edhe në vendin tonë ka bukuri natyrore të tilla që kanë rëndësi historike dhe kulturore. Nëse përqendrohemi në Kosovë, mund



të reflektojmë për shtatë mjediset natyrore në vijim dhe për kontributin e tyre për kulturën, historinë dhe jetesën e njerëzve:

1. Gryka e Rugovës
2. Shpella e Gadimes
3. Ujëvarat e Mirushës
4. Brezovica
5. Burimi i Drinit të Bardhë
6. Bifurkacioni i Nerodimes
7. Kanioni i Drinit të Bardhë

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Shtatë mrekullitë e botës

- Pyetni nxënësit nëse kanë dëgjuar për shtatë mrekullitë antike të botës dhe nëse mund të përmendin ndonjë. Hapni diskutimin duke pyetur apo duke përmendur mrekullitë moderne të botës dhe duke theksuar se shumica e këtyre mrekullive janë bërë nga njerëzit në periudha të ndryshme historike.

- Bisedoni me nxënësit lidhur me kuptimin e mrekullive natyrore të botës dhe mënyrën se si është krijuar kjo listë e këtyre mrekullive. Shfaquni atyre fotografitë e këtyre mrekullive natyrore (shtojca 3.2) dhe pyeti nëse i kanë parë ndonjëherë apo nëse e dinë se ku gjenden.

Aktiviteti kryesor: Fotoalbumi i mrekullive natyrore në Kosovë

- Kërkojuni nxënësve të identifikojnë vende në Kosovë që mund t'i quatin "mrekulli natyrore" dhe krijojnë një listë në tabelë. Pyesni pse mund të ishin ato mrekulli natyrore dhe si identifikohen banorët e Kosovës me to.

- Ndani nxënësit në grupe të vogla. Pajisni secilin grup me një fotoalbum të zbrazët (shtojca 3.1) dhe po ashtu me grumbullin e fotografive të mrekullive natyrore në Kosovë (shtojca 3.3).



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Në vend se të kërkoni nga nxënësit të shkruajnë tekstin që përshkruan fotografitë, mund t'ju ofroni tekstet e gatshme dhe të kërkoni nga ata të çiftëzojnë fotografitë me tekstet.

Aktivitetet pasuese:

- Studentët mund të përgatisin një udhëtim turistik për nxënësit që i vizitojnë nga një shkollë jashtë Kosovës, duke përzgjedhur vendet e trashëgimisë natyrore që më së shumti do të donin t'iu tregonin vizitorëve. Si shtesë, nxënësit mund të marrin më shumë informacion dhe të përgatisin prezantim në mënyrë që të mund të luajnë rolin e ciceronit për vizitorët.

Burime shtesë:

Gjatë përgatitjes apo gjatë realizimit të njësisë, ju mund të shfrytëzoni ueb faqet në vijim:

- http://en.wikipedia.org/wiki/Wonders_of_the_World#Seven_Natural_Wonders_of_the_World
- <http://www.new7wonders.com/>

Videot në YouTube lidhur me mrekullitë natyrore në Kosovë:

- <http://www.youtube.com/watch?v=58NI3NILChU>
- <http://www.youtube.com/watch?v=tEN20yKTRUc&feature=related>
- http://www.youtube.com/watch?v=D_R9FEyzq6E

- Kërkojuni grupeve të përgatisin fotoalbumin duke vendosur fotografitë e mrekullive natyrore të Kosovës nëpër hapësirat e dhëna në fotoalbum dhe duke shkruar nga një tekst nën fotografi, ku shpjegohen ato. Thuaju të shkruajnë ku është dhe pse është një mrekulli natyrore.

- Nxënësit do të vërejnë se një hapësirë ngelet e zbrazët. Kërkoju atyre të vizatojnë një mrekulli tjetër natyrore që duhet të përfshihet në albumin e tyre dhe të shënojnë tekstin përkatës për të.

- Kur të gjitha grupet të përfundojnë fotoalbumin e tyre, krijoni një hartë turistike, duke përdorur grumbullin e ri të fotografive dhe hartën e madhe të Kosovës në klasë. Kërkojini secilit grup me radhë të përzgjedhin një fotografi dhe ta ngjisin në vendin e duhur në hartë. Afër fotografisë grupi duhet të vendosë tekstin që e përshkruan atë. Pastaj pyesni nxënësit për cilat mrekulli tjera natyrore kishin menduar. Ngjitni letrat me emrat e këtyre vendeve në hartë.

Reflektimi

Ndihmoju nxënësve të reflektojnë për vendet e trashëgimisë natyrore në Kosovë duke iu bërë këso pyetjesh:

- A jeni të kënaqur me punën tuaj?
- Çka mësuat nga aktiviteti që zhvilluat?
- A keni mjaft informacion për bukuritë natyrore në Kosovë?
- A duket mirë harta jonë turistike? Si mund ta bëjmë më të mirë? A na duhet dikush të na ndihmojë?
- Çfarë vendi do të kishit dëshirë të vizitoni dhe pse?
- Cila është rëndësia e vendeve të trashëgimisë kulturore apo peizazheve për jetën e banorëve lokalë? A paraqesin ato diçka nga aspekti historik, ekonomik e kulturor?
- Si duhet të silllemi kundrejt peizazheve?

Trashëgimia natyrore

TITULLI: SHSTATË MREKULLITË NATYRORE NË KOSOVË

NIVELI: KLASAT 6 – 9

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë vende të rëndësishme të trashëgimisë natyrore në Kosovë;
- Tregojnë territorin dhe burimet e vendeve të trashëgimisë natyrore të gjetura brenda Kosovës;
- Përshkruajnë rëndësinë e peizazheve dhe mënyrën se si ato ndikojnë në identitetin tonë kulturor;
- Angazhohen në promovimin e vendeve të trashëgimisë natyrore.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Grumbulli i fotografive të shtatë mrekullive të reja natyrore të botës (shtojca 3.2);
- Grumbulli i fotografive të mrekullive natyrore në Kosovë (shtojca 3.3);
- Letra të vogla ngjithëse (etiketa) për votim.

INFORMACIONI PARAPRAK

Kjo njësi shfrytëzon një aktivitet që mbështetet në konceptin e shtatë mrekullive antike të botës. Disa organizata kanë dalë me listën e shtatë mrekullive natyrore të botës. Përpjekja e fundit ka qenë që të krijohet një listë e shtatë mrekullive natyrore në bazë të votimit të përgjithshëm prej 2007 - 2011. Lista është shpallur më 11.11.2011 dhe përfshinë vendet në vijim:

1. Pyjet tropikale të zonës së shirave në Amazonë
2. Gjiri Halong
3. Ujëvarat Iguazu
4. Ishulli Jeju
5. Parku nacional Komodo
6. Lumi nëntokësor Portoprincesa
7. Mali rrafshnaltë në Kejptaun

Ashtu siç këto vende janë të rëndësishme dhe të njohura në botë, edhe në vendin tonë ka bukuri natyrore të tilla që kanë rëndësi historike dhe kulturore. Nëse përqendrohemi në Kosovë, mund



PEIZAZH NGA KOSOVA PERËNDIMORE

të reflektojmë për shtatë mjediset natyrore në vijim dhe për kontributin e tyre për kulturën, historinë dhe jetesën e njerëzve:

1. Gryka e Rugovës
2. Shpella e Gadimes
3. Ujëvarat e Mirushës
4. Brezovica
5. Burimi i Drinit të Bardhë
6. Bifurkacioni i Nerodimes
7. Kanioni i Drinit të Bardhë

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Shtatë mrekullitë e botës

- Pyesni nxënësit nëse kanë dëgjuar për shtatë mrekullitë antike të botës dhe nëse mund të përmendin ndonjë. Hapni diskutimin duke pyetur apo duke përmendur mrekullitë moderne të botës dhe duke theksuar se shumica e këtyre mrekullive janë bërë nga njerëzit në periudha të ndryshme historike.

- Bisedoni me nxënësit lidhur me kuptimin e mrekullive natyrore të botës dhe mënyrën se si është krijuar kjo listë e këtyre mrekullive. Shfaquni atyre fotografitë e këtyre mrekullive natyrore (shtojca 3.2) dhe pyesni nëse i kanë parë ndonjëherë apo nëse e dinë se ku gjenden.

Aktiviteti kryesor: Reklamimi i shtatë mrekullive natyrore në Kosovë

- Kërkojuni nxënësve të identifikojnë vende në Kosovë që mund t'i quanin "mrekulli natyrore" dhe krijoni një listë në tabelë. Pyesni pse mund të ishin ato mrekulli natyrore dhe si identifikohen banorët e Kosovës me to.

- Ndani nxënësit në 7 grupe. U thoni atyre se i kanë fotografitë e shtypura të shtatë peizazheve që ju keni konsideruar se mund të quhen "mrekulli".



Jepni secilit grup fotografinë e njërës nga bukuritë natyrore (shtojca 3.3). Caktojini secilit grup detyrën që të përgatis një reklamë njëminutëshe për atë bukurí natyrore. Thoni se reklama duhet të jetë një mesazh i shkurtër, konciz dhe që tërheq vëmendjen, mu sikur një reklamë.

- Pasi grupet të përgatisin reklamën, u thoni se secili grup do të prezantojë reklamën e vet njëminutëshe, për të promovuar vendin e trashëgimisë natyrore. Grupet tjera duhet t'i dëgjojnë prezantimet me kujdes, në mënyrë që të përzgjedhin reklamën më të preferuar.

- Shpjegoni se duke u bazuar në prezantimet, nxënësit duhet të zgjedhin mrekullinë natyrore që do ta propozojnë për njërin nga shtatë mrekullitë natyrore të botës. Secili grup do të ketë rolin e jurisë dhe do të ketë 5 pikë (letra të vogla ngjitëse) për t'ju dhënë prezantimeve mbi mrekullitë natyrore, me përjashtim se nuk mund të votojnë për prezantimin e vet. Secili grup mund të vendosë se si do të shpërndajë votat e veta. Për shembull, një grup mund t'i japë tri pikë një reklamës së një mrekullie natyrore dhe dy pikë një reklame tjetër.

Reflektimi

Përmblidhni orën mësimore duke bërë pyetje si këto:

- Pse peizazhi jonë konsiderohet të jetë pjesë e trashëgimisë?
- Si mund të përfitojmë nga trashëgimia jonë natyrore?
- Si mund të shprehim kulturën tonë përmes trashëgimisë sonë natyrore?
- Çfarë përgjegjësish kemi përballë vendeve të trashëgimisë natyrore? Pse i kemi këto përgjegjësi?



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Nëse keni qasje në internet dhe projektor në klasë, ju mund të shfaqni mrekullitë e reja natyrore të botës në mur. Po ashtu, mund të përkrahni prezantimet e reklamave duke shfaqur fotografinë e vendit të trashëgimisë natyrore që reklamohet.
- Në vend të votimit, mund të hapni një debat klasor për të vendosur se cili vend duhet të përfshihet në listën e mrekullive natyrore të botës.

Aktivitete pasuese:

- Nxënësit mund t'i shkruajnë letër organizatorit të garës së shtatë mrekullive natyrore të botës, përmes së cilës argumentojnë pse një vend i trashëgimisë natyrore në Kosovë duhet të përfshihet në listën botërore. Kjo do t'ju jepte mundësi nxënësve të tregojnë rëndësinë kulturore dhe historike të vendit.
- Nëse është e mundur, mund t'ju caktoni detyrë grupeve të dalin dhe të incizojnë një videoreklamë pesëminutëshe për vendin e trashëgimisë natyrore që iu është dhënë. Pastaj, mund të organizoni një festival të filmit dokumentar në shkollë.
- Ju mund të organizoni me nxënës një fushatë për mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë natyrore në Kosovë.

Burime shtesë::

Gjatë përgatitjes apo gjatë realizimit të njësisë, ju mund të shfrytëzoni ueb faqet në vijim:

- http://en.wikipedia.org/wiki/Wonders_of_the_World#Seven_Natural_Wonders_of_the_World

- <http://www.new7wonders.com/>

Videot në YouTube lidhur me mrekullitë natyrore në Kosovë:

- <http://www.youtube.com/watch?v=58NI3NILChU>
- <http://www.youtube.com/watch?v=tEN20yKTRUc&feature=related>
- http://www.youtube.com/watch?v=D_R9FEyzq6E

Trashëgimia jomateriale

TITULLI: ENIGMA KULTURORE

NIVELI: KLASAT 3 – 6

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përcaktojnë kuptimin e trashëgimisë së jomateriale (të paprekshme);
- Dallojnë elementeve të ndryshme të trashëgimisë së jomateriale;
- Përshkruajnë rëndësinë që luan trashëgimia e jomateriale në definimin/zhvillimin e kulturës.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Anekdotat (shtojca 4.1)
- Kopjet e enigmës së Kosovës për secilin grup (shtojca 4.2)
- materiale arti (markera, ngjyra, ngjitës, etj)

INFORMACIONI THEMELOR

Qëllimi i njësishës është që nxënësit të njoftohen me konceptin e trashëgimisë jomateriale. Nxënësit do të krijojnë një ekspozitë pamore në klasë për të demonstruar aspekte të ndryshme të trashëgimisë jomateriale. Disa nga aspektet të cilat ju mund t'i mbulonit janë:

- Tregimi i ngjarjeve
- Muzika
- Vallët
- Ushqimi
- Gjuha (duke përfshirë shprehjet/idiomat)
- Veshjet
- Artizanati
- Rituale/ceremonitë
- Etj.

Nxënësit bashkojnë pjesët e enigmës për të shfaqur këto aspekte. Enigma mund të përdoret si një analogji për të shpjeguar se si aspektet e trashëgimisë jomateriale bëhen bashkë për të formuar identitetin kulturor të komunitetit.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Identifikimi i trashëgimisë jomateriale

- Sillni në klasë një apo dy shembuj të



SHITORE ARTIZANALE, GJAKOVË

trashëgimisë jomateriale kulturore për t'ju treguar nxënësve. Për shembull, filloni duke lexuar një anekdotë apo duke kënduar një këngë popullore (një shembull është dhënë në shtojcën 4.1)

- Pastaj, ndihmoni nxënësit të mendojnë dhe përmendin më shumë shembuj të trashëgimisë jomateriale. Bëni një listë të aspekteve të paprekshme në tabelë (si lista më lartë) dhe ndihmoni nxënësit të mendojnë për shembuj nga secili aspekt.

Aktiviteti kryesor: Krijimi i enigmës kulturore

Nxënësit do të krijojnë enigma të trashëgimisë jomateriale kulturore për të demonstruar elementet e ndryshme të trashëgimisë jomateriale. Secili nxënës do të dekorojë një pjesë të një enigme.

- Ndani nxënësit në grupe prej gjashtë vetave (janë gjashtë pjesë të një enigme).

- Jepni secilit grup hartën-enigmë të Kosovës (shtojca 4.2) dhe u thoni t'i prenë copat e enigmës.

- Caktoni secilin grup të përqendrohet në një aspekt të kulturës jomateriale. Për shembull, grupi 1 do të merret vetëm me gatimin e ushqimit dhe do të kenë për detyrë të dalë me një listë të disa llojeve të ushqimeve. Grupi 2 do të përqendrohet në muzikë e valle dhe do të vijin me një listë të llojeve të ndryshme të muzikës dhe valleve në Kosovë. Inkurajoni nxënësit të mendojnë ide të ndryshme që paraqesin aspektin e tyre të kulturës jomateriale.



- Pasi grupet të kenë përfunduar listën e ideve, jepni detyrë secilit individ brenda grupit të shkruajë/ vizatojë njëri ide nga lista në njëri nga copëzat e enigmës.

- Kur secili individ në grup përfundon së dekoruari pjesën e vet të enigmës, atëherë të gjithë nxënësit, më pjesën e vet në dorë, do të lëvizin nëpër klasë për të krijuar grupet e reja. U thoni nxënësve të formojnë grupe të reja të bazuara në gjashtë numra të ndryshëm të pjesëve të enigmës. Për shembull, një person nga grupi i muzikës, një nga grupi i ushqimit, etj., do të bëhen bashkë për të formuar grupin e ri dhe secili do të kontribuojë me një pjesë të enigmës së Kosovës. Duhet të jenë 6 apo 7 enigma të kompletuara (varësisht nga madhësia e klasës). Në fund, klasa do të ketë të përgatitur një ekspozitë pamore që paraqet trashëgiminë jomateriale në Kosovë.

Reflektimi

Nxënësit do të jenë në gjendje të shohin se aspektet e veçanta të kulturës jomateriale ndihmojnë në krijimin e fotografisë së tërësishme të trashëgimisë kulturore jomateriale në Kosovë. Bëjuni nxënësve pyetjet në vijim për fotografitë:

- Çfarë trashëgimie e paprekshme është paraqitur në punimet e kompletuara?
- A mendoni se kjo është e saktë/e duhur?
- Çka tjetër do të mund të reflektohej në punime?



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Ndani nxënësit në 4 – 6 grupe. Jepni secilit individ në grup 1 apo 2 pjesë për t'i kompletuar. Jepni për detyrë secilit individ të përqendrohet në një lloj të trashëgimisë kulturore jomateriale (një person merr ushqimet, tjetri artet, etj.). Jepuni nxënësve kohë t'i disenjojnë dhe të shkruajnë mbi pjesët e veta. Pasi secili person të ketë përfunduar punën, u thoni t'i bëjnë bashkë pjesët e veçanta. Grupet mund të ngjisin punimet e veta në një letër të madhe, që të mund të ekspozohen.

Aktivitetet pasuese:

- Kolazhi i copëzave të enigmës: Ju mund t'iu jepni nxënësve një kopje të prespektit të një enigma me copëza dhe nxënësit t'i dekorojnë me aspekte të veçanta të trashëgimisë jomateriale. Nxënësit mund t'i prejnë copat dhe një kolazh klase mund të krijohet me të gjitha copat e enigmës.

Burime shtesë:

- Këshilli i Evropës, Dokumentari i trashëgimisë jomateriale, Kosovë
- Ueb faqja në vijim ofron informacion të ndryshëm për trashëgiminë jomateriale: <http://www.unesco.org/culture/ich/doc/src/01857-EN.pdf>

Trashëgimia jomateriale

TITULLI: ENIGMA E ANTROPOLOGUT KULTUROR
NIVELI: KLASA 6 – 9
KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përcaktojnë kuptimin e trashëgimisë jomateriale dhe të dallojnë elemente të ndryshme të trashëgimisë jomateriale;
- Përkrahajnë rëndësinë që luan trashëgimia jomateriale në përcaktimin/zhvillimin e kulturës;
- Kuptojnë konceptin e të qenit antropolog kulture;
- Analizojnë trashëgiminë jomateriale, që të nxjerrin përfundime për vlerat dhe besimet e një shoqërie.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Artifakte kulture nga ndonjë kulturë tjetër ose fotografi të artifakteve të lashta. Shembujt janë dhënë në shtojcën 4.3. Përqendrohuni në mënyrën e krijimit të këtyre artifakteve dhe historive që vijnë me ato artifakte.

INFORMACIONI PARAPRAK

Kjo njësi kërkon nga nxënësit që të shkojnë më thellë në çështje të trashëgimisë jomateriale kulturore, duke iu kërkuar atyre të mendojnë dhe të sillen si antropologë kulture. Roli i antropologut të kulturës është që të kërkohet që të kuptohet logjika e brendshme e një shoqërie në lidhje me sjelljen njerëzore, zakonet, marrëdhëniet, sistemin e besimeve dhe ritualeve, etj. Nxënësit do të duhet të përcaktojnë se si aspektet e trashëgimisë jomateriale në Kosovë portretizojnë sistemin e vlerave dhe besimeve në Kosovë.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Të qenit një antropolog

- Filloni duke folur për rolin e një antropologu.
- U thoni nxënësve se ata do të luajnë rolin e një antropologu dhe duhet të zbulojnë më shumë për civilizimet.
- Tregojuni nxënësve një apo më shumë artifakte që keni sjellë në klasë. Nëse nuk keni një artifakt, mund t'ju tregoni nxënësve fotografi të artifakteve nga Egjipti i lashtë (shtojca 4.3)



SHITORE ARTIZANALE, GJAKOVË

- Së pari, kërkojuni nxënësve të identifikojnë sendin apo sendet dhe përdorimin e tyre.
- Pastaj, pyesni ata se çfarë tregojnë këto sende për kulturën. Çfarë vlerash/bindjesh janë demonstruar përmes këtyre sendeve? Duke shikuar në këto sende, çfarë mund të supozojmë se ka qenë me rëndësi për njerëzit e kësaj kulture?
- Ndhimojuni nxënësve të kuptojnë se sendet e prekshme (ndërtesat dhe artifaktet) ndihmojnë të reflektojmë për aspektet jomateriale të një kulture.
- Si klasë, përcaktoni trashëgiminë jomateriale apo jo materiale dhe krijoni një listë të elementeve të trashëgimisë jomateriale.

Aktiviteti kryesor: Një antropolog në Kosovë

- Ndani nxënësit në grupe të vogla (3-4 veta).
- Kërkojuni atyre që brenda grupit të mendojnë dhe diskutojnë për ndonjë gjësend që paraqet një aspekt kulture nga Kosova. Le të mendojnë për artifakte që mund të gjejnë në muzeun nacional apo gjëra si elemente të artit, muzikës, veshjeve, gatimit, inventarit shtëpiak, etj.
- Kërkoni që secili grup të vendosë për një gjësend dhe të vizatojnë atë gjësend në një letër.
- Pasi të gjitha grupet të kenë përfunduar vizatimin, grumbullojini punimet dhe shpërndani sërish nëpër grupe (mbani kujdes që asnjë grup të mos marrë vizatimin e vet).



DEF, INSTRUMENT MUZIKOR TRADICIONAL



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Jepni secilit nxënës një pjesë nga harta-enigmë e Kosovës (shtojca 4.1) (Copat e enigmës duhet të jenë të prera që përpara, ashtu që secili nxënës pranon një pjesë nga enigma). Kërkojuni nxënësve të mendojnë për ndonjë gojëdhënë, këngë, apo ceremoni që përfaqëson aspekte të trashëgimisë kulturore jo materiale (nxënësit duhet të jenë sa më specifike që është e mundur). Në secilën nga pjesët e enigmës, nxënësit duhet të shkruajnë apo të vizatojnë një objekt që lidhet me elementin specifik të trashëgimisë së paprekshme. Pasi që secili nxënës të përfundojë punën në pjesën e vet të enigmës, ata do t'i japin pjesën një nxënësi tjetër për ta analizuar. Tash nxënësit duhet të luajnë rolin e antropologut që sapo ka zbuluar një objekt. Ata e shikojnë copën që kanë marrë dhe flasin apo shkruajnë lidhur me çfarë ajo copë e enigmës thotë për kulturën. Çfarë thotë ajo copë për bindjet dhe vlerat në Kosovë? Secili duhet të shkruaj një raport të gjetjeve lidhur me copën e marrë nga shoku apo shoqja. Pastaj nxënësit mund të vendosin copëzat së bashku, ashtu që të krijojnë një vepër pamore të madhe të kësaj kulture.

Aktivitete pasuese:

- Nxënësit mund të shkojnë në shtëpi dhe të marrin objekte, për t'i sjellë në klasë dhe për të diskutuar më tutje për temën.
- Nxënësit mund të mbledhin fotografi, receta, tregime që mund të grumbullohen në një libër antropologjik të klasës.
- Nxënësit mund të krijojnë një kalendar të kulturës, në bazë të gjërave të mbledhura si fotografitë, recetat, tregimet, etj.

Burime shtesë:

- Këshilli i Evropës, Dokumentari "Ditët e trashëgimisë jomateriale", Kosovë
- <http://www.unesco.org/culture/ich/doc/src/01857-EN.pdf>
- American Anthropological Association
- National Geographic Website

- Tash, u thoni nxënësve se ata janë antropologë dhe sapo kanë zbuluar këtë send.

- Së pari, ata duhet të identifikojnë gjësendin, apo të shprehën se çfarë ata mendojnë se është.

- Pastaj, kërkojuni të flasin lidhur me çfarë përfaqëson ky objekt për kulturën në Kosovë. Pse është ky objekt apo gjësend i rëndësishëm? Çfarë na thotë ky objekti për vlerat/besimet në Kosovë? A mund të kuptojmë diçka lidhur me marrëdhëniet (familja, shoqëria) nga ky gjësend?

Reflektimi

- Kërkojuni secilit grup me radhë të tregojë fotografinë që kanë dhe të përshkruajnë shkurtimisht se çfarë përfaqëson ajo për kulturën në Kosovë.

- Cilat vlera i shfaq objekti?

- A e ilustron objekti rëndësinë e ritualeve apo ceremonive? Nëse po, si?

Përmblidhni njësinë duke përfunduar te nxënësit faktin se kultura i ka disa shtresa. Objektet (gjërat apo objektet), statujat dhe ndërtesat demonstrojnë trashëgiminë e prekshme kulturore, por po ashtu këto tregojnë edhe vlerat/besimet dhe ritualet e një shoqërie. Një antropolog i mirë e interpreton trashëgiminë e prekshme kulturore ashtu që të kuptojë bindjet dhe besimet e njerëzve dhe të krijojë një fotografi më gjithëpërfshirëse të kulturës së një shoqërie.

Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore

TITULLI: ARKA E BASHKËSISË SONË

NIVELI: KLASAT 3-të

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë rolin e një arkeologu, historiani arti, arkitekti apo një profesionisti tjetër që është i përfshirë në kërkimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore;

- Tregojnë mënyrat dhe arsytet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

- Japin shembuj se si trashëgimia kulturore është apo duhet të jetë e mbrojtur në Kosovë;

- Pranojnë se të gjithë njerëzit kanë përgjegjësi për të ruajtur trashëgiminë kulturore.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Tre shembuj janë dhënë për aktivitetin hyrës, por ju mund të krijoni më shumë shembuj për t'ia qëlluar, para se të fillojë ora mësimore.

- Kopjet e sëndukut të bashkësisë (komunitetit) për secilin grup (shtojca 5.1).

INFORMACIONI PARAPRAK

Ideja e kësaj njësie është që të shikohet në ruajtjen dhe promovimin e kulturës nga këndvështrimi i profesionistëve të fushës. Ata gjurmojnë të kaluarën duke gjetur, analizuar dhe interpretuar objektet. Prandaj, nxënësit do të udhëzohen të luajnë rolin e arkeologut apo historianit të artit që sapo ka zbuluar një objekt nga bashkësia e vet. Nxënësit pastaj do të diskutojnë mënyrat për të mbrojtur dhe arsytet pse duhet ruajtur objektet që zbulohen.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Ku gjendem unë?

- Filloni duke diskutuar rolin e arkeologëve, historianëve të artit, arkitektëve apo profesionistëve tjerë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Ata zakonisht kërkojnë për gjëra që kanë



URA E ZALLÇIT, ISTOG

ngelur nga e kaluara në formën e artifakteve apo të dhënave tjera, në mënyrë që të krijojnë një kuptim për të kaluarën.

- Pastaj, kërkujuni nxënësve të provojnë të qenit profesionistë përmes lojës së marrjes me mend. Tregojuni nxënësve se gjërat në vijim janë gjetur dhe kërkujuni t'ia qëllonjë se ku mund të jenë gjetur këto gjëra. Është e thjeshtë, por do të demonstrojë se si i analizoni objektet dhe i bëni parashikimet. Pyetini ata pse i dhanë përgjigjet ashtu

- Janë gjetur gjërat në vijim:

- Kapelë festive, bri, shirit gjarpërues, ftesë për festë, ëmbëlsira dhe pije. Ku mund të jeni? Përgjigjja është festa.

- Lapsa, goma, letra, vizore, shkurmesa, libra. Ku mund të jeni? Përgjigjja është shkolla.

- Brushë, pastë e dhëmbëve, gargarë (lëndë për shpëlarjen e gojës), brushë për dhëmbë, sapun. Ku mund të jeni? Përgjigjja është banjo.

- Shpjegojuni nxënësve se arkeologët e kryejnë të njëjtin aktivitet të të menduarit. Sidoqoftë, ata kërkojnë të gjejnë artifakte nga e kaluara dhe duhet të vijnë te përfundimet se çfarë shprehin objektet për kulturën dhe njerëzit.

Aktiviteti kryesor: Krijimi i sëndukut të bashkësisë

Ky aktivitet është i kundërt me aktivitetin hyrës. Nxënësit e dinë vendin – bashkësinë ku jetojnë. Qëllimi është që ata të mendojnë për artifakte të rëndësishme (gjëra materiale) që një arkeolog mund t'i zbulojë pas 200 apo më shumë viteve.



- Ndajini nxënësit në grupe të vogla prej 3-5 vetave.
- Thuajuni nxënësve se jemi 200 vjet në ardhmëri dhe se ata janë arkeologë. Ata po gërmojnë në bashkësinë e tyre.
- Këshillojini nxënësit të punojnë në grupe dhe të vijnë me 5 gjëra/artifakte të rëndësishme nga bashkësia e tyre të cilat mund t'i zbulojnë një arkeolog në të ardhmen.
- Jepni secilit grup fletën e punës "Arka e bashkësisë" (Shtojca 5.1) dhe kërkojuni të vizatojnë apo të shkruajnë objektet nga bashkësia e tyre që ata mendojnë se janë të rëndësishme nga aspekti i kulturës (mund të jenë CD muzike, pjesë të veshjeve, ndërtesa, etj.)

Reflektimi

- Kërkojuni nxënësve të ndajnë me të tjerët fletët e tyre të punës përmes një seance prezantimi. Ata duhet të flasin për objektet që i kanë vizatuar apo shkruar, duke shpjeguar se çfarë do të thotë objektet për ta dhe si e paraqet kulturën e tyre. Në fund, diskutoni se si arka e bashkësisë së tyre duhet të mbrohet dhe pse. Pyetjet e mundshme për t'ju ndihmuar nxënësve të reflektojnë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore mund të ishin:
- Çfarë mund të bëhet që objektet të mos shkatërrohen?
 - Çfarë mund të bëjmë ne si individë për të ndihmuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?
 - Kush duhet të mbrojë këto objekte e ndërtesa në të ardhmen?



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Aktiviteti kryesor mund të zhvillohet edhe individualisht, ashtu që secili nxënës të krijojë arkën e bashkësisë së vet. Pastaj, këto arka mund të ekspozohen në klasë.

Aktivitete pasuese:

- Udhëzoni nxënësit të mendojnë se si mund të mbrojnë gjërat në arkën e bashkësisë së tyre. U thoni nxënësve se duhet të krijojnë një shprehje speciale që të shërbejë si fjalëkalim për të hapur arkën e tyre. Shprehja-fjalëkalim duhet të simbolizojë një mënyrë se si ata mund të mbrojnë objektet e trashëgimisë kulturore. Për shembull: "Unë nuk do të hedh mbeturina në rrugët e bashkësisë sime." Është si një frazë-fjalëkalim në formë të zotimit që do të ndihmojë në mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë.
- Krijoni një arkë të bashkësisë së klasës që është një paraqitje e gjallë e objekteve kulturore prej bashkësisë suaj, që ju dëshironi t'i ruani dhe t'ju kaloni gjeneratave të ardhshme. Siguroni një kuti të madhe që të shërbejë si arkë bashkësisë suaj. Kërkojini secilit nxënës të sjellë një objekt për ta futur në kuti.

Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore

TITULLI: ARTIFAKTET

NIVELI: KLASAT 6 - 9

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë rolin e një arkeologu, historiani arti, arkitekti apo një profesionisti tjetër që është i përfshirë në kërkimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- Tregojnë se çka do të thotë mbrojtja e trashëgimisë kulturore;
- Japin shembuj se si trashëgimia kulturore është apo duhet të jetë e mbrojtur në Kosovë;
- Pranojnë se ata janë përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Shqyrtojnë mënyrat për të përfshirë bashkësinë e tyre në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Kopje të tabelës me artefakte për secilin nxënës (shtojca 5.2);
- Sillni shembuj të artefakteve kulturore (te vjetra dhe të reja) CD, veshje, fotografi të artefakteve, etj.

INFORMACIONI PARAPRAK

Ideja e kësaj njësie është që të shikohet në ruajtjen dhe promovimin e kulturës nga këndvështrimi i profesionistëve të fushës. Prandaj, nxënësit do të udhëzohen të luajnë rolin e profesionistit që kërkon në bashkësinë e vet. Nxënësit pastaj do të diskutojnë mënyrat për të mbrojtur dhe arsyt pse duhet ruajtur artefaktet që zbulohen.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Puna e një arkeologu

- Filloni duke diskutuar rolin e profesionistëve të fushës (arkeologëve, historianëve të artit, etnologëve, etj.). Ata zakonisht kërkojnë për gjëra që kanë ngelur nga e kaluara në formën e



MANASTIRI I DEÇANIT (DETAL)

artefakteve apo të dhënave tjera, në mënyrë që të krijojnë një kuptim për të kaluarën. Nxënësit, pastaj do të diskutojnë se çka na tregojnë artefaktet për kulturën dhe njerëzit.

- U thoni nxënësve se një ekspeditë arkeologjike në shkollën tuaj së voni ka zbuluar një numër të artefakteve që ata tash duhet t'i kontrollojnë dhe t'i interpretojnë. Theksoni se ata janë përzgjedhur për këtë punë sepse janë ndër ekspertët më të mirë për vendndodhje arkeologjike (apo ekspertë për monumente arkitektonike, vende historike, peizazhe kulturore, etj.).

- Ndani nxënësit në katër apo pesë grupe me madhësi të njëjtë.

- Jepni secilit nxënës nga një kopje të tabelës me artefakte (shtojca 5.2) dhe afrojeni secilit grup një artefakt.

- Kërkojini secilit grup të shikojë në secilin artefakt që keni sjellë, në mënyrë që të jenë në gjendje të plotësojnë tabelën e tyre.

- Këshilloni nxënësit të shikojnë secilin prej këtyre gjësendeve dhe të plotësojnë tabelën e artefakteve. Rrotulloni artefaktet nëpër klasë në mënyrë që secili grup të mund ti shohë këto objekte.

- Kërkojuni nxënësve të mendojnë për artefakte/ gjësende tjera prej kulturës së tyre dhe t'i shkruajnë në tabelën e tyre.



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Për të bërë analizimin e objekteve më sfidues, në vend që të përdorni tabelën e artifakteve, u thoni nxënësve që të kategorizojnë objektet sipas tabelës në vijim. Kërkojuni nxënësve që në grupe të krijojnë një listë të simboleve/paraqitjeve të trashëgimisë kulturore në Kosovë duke u bazuar në tri kategori dhe të mendojnë se ku mund të gjenden këto në bashkësinë e tyre.

Paraqitje pamore
Fotografi/piktura/
vizatime/shkrime

Paraqitje gojore
• Tregime
• popullore/
• përralla/rituale
• gojore/
• muzikë

Paraqitje trupore
• valle/punë dore/
• rituale

Aktiviteti kryesor: Organizimi i një ekspozite muzeore

Tash që nxënësit kanë idenë e përgjithshme për identifikimin dhe shqyrtimin e artifakteve, ata duhet të përqendrohen në mënyrat për mbrojtjen dhe promovimin e tyre.

- Nxënësit mund të rrinë në grupet e tyre.
- Kërkojini secilit grup të shikojnë në tabelat që i plotësuan në aktivitetin paraprak dhe të zgjedhin njërin objekt.
- U thoni nxënësve të bëjnë sikur punojnë në muze dhe se objekti që kanë zgjedhur do të jetë i ekspozuar aty. Udhëzohini nxënësit të shkruajnë një shpjegim të shkurtër për objektin.

Reflektimi

- Kërkoni nga përfaqësuesit e secilit grup të prezantojnë se çka kanë shkruar. Pasi secili grup të ketë paraqitur idetë e tyre, diskutoni si klasë se çka mund të bëjnë individët për t'u siguruar se objektet do të mbrohen
- Çka duhet të bëjnë njerëzit që të sigurohen se këto gjëra dhe kultura që përfaqësojnë ato nuk do të shkatërrohen?
 - A ka diçka që mund të bëjnë individët për të ruajtur kulturën për gjeneratat e ardhshme?
 - A ka diçka që mund të bëjmë si klasë?
 - Çfarë mund të ndodh nëse ne nuk e ruajmë kulturën tonë?

- Nxënësit pastaj mund të mendojnë mënyra për të edukuar njerëzit në bashkësinë e tyre për këto paraqitje. Ata mund të organizojnë një fushatë vetëdijesimi për njërin nga shembujt nga tabela e tyre.

Aktivitete pasuese:

- Kërko nga nxënësit të planifikojnë dhe të paraqesin një ekspozitë për promovimin e simboleve/paraqitjeve të ndryshme kulturore që ata i mbledhin në bashkësinë e tyre.
- Nxënësit mund të krijojnë një fushatë me afishe për të edukuar bashkësinë e vet për trashëgiminë e tyre kulturore dhe mënyrat për ta ruajtur atë.
- Nxitni nxënësit të futen në internet dhe të kërkojnë ligjet që mbrojnë vendet arkeologjike.
- Cilat lloje të vendeve janë të mbrojtura?
- A ju duhet një leje arkeologjike nga qeveria për të grupuar në ato vende?
- Nëse është e mundur, vizitoni një vend arkeologjik dhe bisedoni me agjencitë që ndihmojnë në mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore.

Burime shtesë:

- Ueb faqja në vijim paraqet Ligjin për trashëgiminë kulturore në Kosovë
http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf

Diversiteti: identiteti jonë

TITULLI: KUSH JAM UNË?

NIVELI: KLASAT 3 – 6

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë karakteristikat dhe zotësitë e tyre dhe të tregojnë se si i kanë fituar ato zotësi e karakteristika;
- Identifikojnë aspektet e përgjithshme që ndikojnë në formimin e identitetit;
- Kuptojnë se si identiteti jonë formohet nën ndikimin e mjedisit tonë

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Një hapësirë e gjerë duhet për ta zhvilluar aktivitetin hyrës
- Kopje të fletës së punës “Kush jam unë” për secilin nxënës (shtojca 6.1)

INFORMACIONI PARAPRAK

Për të kuptuar idenë e diversitetit dhe ndërveprimet me njerëzit tjerë, së pari duhet të mësojmë për vetveten dhe për mënyrën se si e interpretojmë botën duke u bazuar në atë se kush jemi dhe në idetë dhe bindjet tona. Kjo njësi synon që të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se kush janë si individë dhe prej nga mund të vinë idetë dhe bindjet e tyre. Njësia bazohet në reflektimin e nxënësve mbi vetveten.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Të gjitha ata që...

- Kërkojuni nxënësve të qëndrojnë në njërën anë të klasës.
- Sqarojuni atyre se ju do të lexoni disa deklaratat që fillojnë me “Të gjithë ata që...” dhe vazhdojnë me disa fakte. Pas secilës deklaratë, nxënësit të cilëve u përshtatet deklaratat duhet të kalojnë në anën tjetër të klasës. Shembull: nëse u thoni “Të gjithë ata që kanë motra dhe vëllezër”, atëherë ata nxënës që kanë motra dhe vëllezër duhet të kalojnë në anën tjetër.



FËMIJË DUKE LUAJTUR (PUNIM QERAMIKE), NGA SEVCAN CERKEZ

- Filloni të lexoni deklaratat një nga një dhe jepuni kohë nxënësve që duan të lëvizin, ta bëjnë këtë.
- Kur nxënësit të kenë lëvizur, mund t'u bëni atyre pyetje pasuese lidhur me deklaratën, si p.sh.: Sa motra dhe vëllezër ke?
- Zgjidhni deklaratat që mbulojnë informata që dihen, por edhe të tjera që nuk dihen nga të tjerët në klasë. Disa shembuj mund të jenë:
 - Të gjithë ata që i duan sportet më shumë se muzikën;
 - Të gjithë ata që kanë lexuar “X” romanin;
 - Të gjithë ata që mbajnë syze;
 - Të gjithë ata që jetojnë në familje me më shumë se pesë anëtarë.
- Proveni të përfundoni me një deklaratë që i lëviz të gjithë nxënësit, si p.sh. “Të gjithë ata që janë nxënës të klasës së gjashtë”.
- Përmes diskutimit që bëni me nxënësit për aktivitetin dhe për rezultatet pas deklaratave, theksoni idenë se sa të larmishëm jemi, në njërën



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Gjeni një libër apo video për vetvlerësimin, fëmijët e mahnitshëm, fëmijët në vendet tjera, etj., për ta ndarë me nxënësit.

anë dhe, sa ngjashmëri kemi me të tjerët, në anën tjetër.

Aktiviteti kryesor: Kush jam unë?

- Përgatitni nxënësit që të mendojnë më thellë për vetveten – aftësitë e tyre, karakteristikat, çka pëlqejnë e çka jo, etj. Thoni atyre se ndonëse kanë karakteristika të përbashkëta me të tjerët, megjithatë ata kanë një personalitet unik.

- Jepni secilit nxënës fletën e punës “Kush jam unë?” (shtojca 6.1). Kërkojuni që të punojnë individualisht dhe t’u përgjigjen pyetjeve. (Keni kujdes që t’u thoni të shkruajnë emrat e tyre nëpër fletët e tyre të punës. Pasi të kenë përfunduar, grumbulloni fletët e punës dhe ruani për njësinë tjetër mësimore).

Reflektimi

Hapni diskutimin duke i pyetur nxënësit për procesin e formimit të identitetit dhe për faktorët që ndikojnë në këtë proces. Pyesni ata:

- Cilët nga njerëzit janë të rëndësishëm në jetën tuaj? Si ndikojnë ata në ju?

- Cilat ngjarje në jetën tuaj nuk do t’i harroni kurrë?

- Cilave grupe apo organizata u takoni ju? Pse bëni pjesë në këto organizata?

- Cilët filma, programe tjera televizive apo cila muzikë ju pëlqen?

- A mund të mendoni për disa ndikime që nuk vijjnë doemos nga rrethi juaj i ngushtë?

Ju mund të përfundoni duke thënë se secili duhet të jetë i vetëdijshëm për identitetin e vet dhe për mënyrën se si është formuar ky identitet. Identiteti jonë është formuar nga rrethi jonë i ngushtë (familja, shokët, shkollja, etj.), nga ngjarjet me rëndësi në jetë, grupet me të cilat bashkohemi, historia kombëtare apo lokale dhe kultura e popullarizuar, ashtu sikur se edhe nga zhvillimet globale. Këta janë të gjithë faktorët që kontribuojnë në atë çka ne besojmë dhe vlerësojmë.

Diversiteti: identiteti jonë

TITULLI: KORNIZA JONË

NIVELI: KLASAT 6 – 9

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë aspektet e përgjithshme që ndikojnë në formimin e identitetit;
- Përkrahajnë karakteristikat dhe zotësitë e tyre dhe të tregojnë se si i kanë fituar ato zotësi e karakteristika;
- Kuptojnë se si identiteti jonë formohet nga ndikimet që vijnë nga rrethi i ngushtë dhe nga zhvillimet globale;
- Pranojnë idenë se identiteti nuk është i pandryshueshëm, por është në ndryshim të vazhdueshëm.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Një hapësirë e madhe për nxënësit, që të lëvizin gjatë aktivitetit hyrës;
- Kopje të shabllonit të kornizës për secilin nxënës (shtojca 6.2);
- Letra të formatit A4 apo A5, markera, ngjitës;
- Mos harroni t'i grumbulloni kornizat dhe t'i ruani ato për njësinë tjetër mësimore;

INFORMACIONI PARAPRAK

Për të kuptuar idenë e diversitetit (larmisë) dhe ndërveprimit me njerëzit tjerë, së pari duhet të mësojmë për vetveten dhe për mënyrën se si e interpretojmë botën duke u bazuar në atë se kush jemi dhe në idetë dhe bindjet tona. Kjo njësi synon që të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se kush janë si individë dhe çka ka ndikuar që të krijojnë idetë dhe bindjet e tyre. Nxënësit do të plotësojnë kornizat e tyre dhe do të reflektojnë për vetveten. Diskutimi në klasë do të lehtësojë procesin e analizimit të ndikimeve prej rrethit.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Vënia e vetes në kornizë

- Jepni secilit nxënës një shabllon të kornizës (shtojca 6.2). Kërkoju atyre të punojnë individualisht.



KUPOLLA E XHAMISË SULTAN MEHMET FATIH, PRISHTINË

- Ata duhet të shkruajnë emrat e tyre në brendësi të kornizës (opsion më i mirë do të ishte të vendosin fotografinë e tyre, nëse është e mundur).

- Kërkojuni nxënësve të plotësojnë kutitë rreth kornizës së tyre. Udhëzoni ata të shprehin karakteristika personale dhe aspekte të jetës që janë të rëndësishme për ta, siç mund të jenë: preferencat, vlerat, besimet, fakte sociale (familja, shkolla, anëtarësia në ndonjë grup), etj. Ju mund të jepni një shembull për veten: "Kam luajtur pingpong" apo "Jam i martuar dhe kam një djalë".

- Pasi nxënësit të kenë përfunduar me plotësimin e kornizës së tyre, grumbulloni ato dhe ruani për njësinë tjetër mësimore.

Aktiviteti kryesor: Çka ndikon në identitetin tim?

- Shfrytëzoni hapësira të ndryshme në klasë për të ekspozuar letra A4 në të cilat janë të shkruar faktorë të ndryshëm që kanë ndikim mbi njerëzit.

Faktorët:

- Familja
- Shokët e shoqet
- Sportet
- Artet/Literatura
- Shkollja
- Media
- Njerëzit e famshëm
- Qeveria



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Aktivitetet pasuese:

- Hulumtoni se si media ndikon në krijimin e imazhit mbi veten. Paraqitni disa fotografi prej revistave apo disa videoklipe dhe pyesni nxënësit se si media formon imazhin tonë. Ndhimojuni të mendojnë se si media e përkufizon të bukurën, mashkullinë apo femërinë. Kërkoni nga nxënësit që të analizojnë reklamat nëpër revista dhe të përkufizojnë mesazhin që japin dhe ndikimin që kanë.

- Gjurmoni mbi një tregim popullor nga historia lokale dhe diskutoni se si ky ndikon në identitetin. Paraqisni imazhe historike dhe analizoni domethënien e tyre.

- Tjetër

- Kërkojuni nxënësve të shikojnë në kornizën e tyre dhe të vendosin faktorin kryesor që ka ndikim në atë se kush janë. Nxënësit duhet të shikojnë letrat përreth klasës dhe të pozicionohen te letra që përfaqëson faktorin më të rëndësishëm që ndikon te ata.

- Pasi që secili të shkojë te një letër, shikoni se te cila letër po rrinë më së shumti nxënës dhe pyesni ata se si ndikon ky faktor te ata.

- Pastaj, ndani nxënësit në grupe të vogla dhe jepni secilit grup nga një faktor. Për shembull, një grup do të ketë “shkolla”, një tjetër “media”, e kështu me radhë.

- Jepuni nxënësve disa minuta për të diskutuar se si ky faktor ndikon te njerëzit. Për shembull, në çfarë mënyrash shkolla ndikon te njerëzit.

- U thoni nxënësve nga grupet që të raportojnë para klasës për atë që diskutuan.

Reflektimi

- Kërkojuni nxënësve të reflektojnë për kornizat e tyre. Filloni diskutimin duke i pyetur se cilat ndikime kanë ndihmuar në formimin e identitetit, bindjeve e vlerave të tyre:

- Pse vlerësoni gjëra të caktuara?

- Prej nga burojnë vlerat apo bindjet tuaja?

- Cilat janë ndikimet më me rëndësi në jetën tuaj?

- A mund të kujtoni disa ndikime që nuk vijnë doemos nga rrethi i ngushtë?

- Kujtojuni nxënësve se identiteti jonë është formuar nga rrethi jonë i ngushtë (familja, shokët, shkolla, etj.), nga ngjarjet me rëndësi në jetë, grupet me të cilat bashkohemi, historia kombëtare apo lokale dhe kultura e popullarizuar, ashtu sikur se edhe nga zhvillimet globale. Këta janë të gjithë faktorë që kontribuojnë në atë çka ne besojmë dhe vlerësojmë.

- Ndhimojuni nxënësve të kuptojnë se ideja jonë për veten është në ndryshim të vazhdueshëm, duke i pyetur:

- A mendoni se korniza juaj është dukur e njëjtë kur keni qenë në klasën e tretë? A do të duket e njëjtë kur t’i keni 30 vjeç? Pse, ose pse jo?

Përfundoni duke thënë se identiteti jonë nuk është statik por dinamik, prandaj është në gjendje të zhvillimit dhe ndryshimit të vazhdueshëm.

Diversiteti: Perceptimet e ndryshme

TITULLI: A PO E SHOH TËRË FOTOGRAFINË?

NIVELI: KLASAT 3 - 6

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të

- Kuptojnë domethënien e supozimeve dhe stereotipeve;
- Pranojnë se njerëzit kanë perceptime të ndryshme lidhur me atë që shohin;
- Shpjegojnë se si njerëzit e ndryshëm mund të interpretojnë realitetin e njëjtë në mënyra të ndryshme;
- Kuptojnë se ne interpretojmë kulturat tjera përmes perceptimeve tona.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Sillni fletët e punës “Kush jam unë?” të plotësuar nga nxënësit në orën e kaluar;
- Nxënësit duhet të ulen në çifte për aktivitetin hyrës;
- Për aktivitetin me statujë, karriget/bankat duhet të jenë të rregulluara në rreth apo në katër kënde.

INFORMACIONI PARAPRAK

Qëllimi i kësaj njësie mësimore është që të ndihmojë nxënësit të vetëdijesohen se ne mund të shohim gjërat nga perspektiva apo këndvështrime të ndryshme. Po ashtu duam t’ju demonstrojmë nxënësve se shpesh bëjmë supozime që janë të pasakta, kur shikojmë një gjë vetëm nga një këndvështrim.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Përshkrimi i partnerit tim

- U thoni nxënësve të ulen me një partner
 - Nxënësit nuk lejohen të flasin me partnerin.
- Kërkojuni nxënësve të mendojnë për jetën e partnerit të tyre dhe se kush është ai/ajo. Nxënësit duhet të përqendrohen në aspekte që nuk janë të dukshme.
- Kërkojuni nxënësve që të shkruajnë disa gjëra që mendojnë se lidhen me jetën e partnerit të tyre. Për shembull, dikush mund të mendojë se partneri i tij/saj vjen nga një familje e madhe, apo se partneri



i tij/saj ka dëshirë të luaj futboll. Jepuni atyre pak kohë të mendojnë dhe të shkruajnë lidhur me partnerin e tyre.

- Tash, jepni secilit nxënës fletën e punës “Kush jam unë” të partnerit, të plotësuar gjatë orës së kaluar mësimore. Kërkojuni nxënësve që të krahasojnë këtë fletë pune me atë çka kanë shkruar ata për partnerin. Kërkonin nga dy apo tre nxënës që të tregojnë se çka kanë zbuluar, por mos lejoni të shkojnë më thellë në analizë, në këtë fazë.

Aktiviteti kryesor: Statuja

- Rregulloni karriget në rreth apo në katër kënde të klasës.
- Kërkonin dy apo tre vullnetarë. Kërkojuni atyre të dalin për pak minuta jashtë klasës me ju. Shpjegojuni se ata duhet të qëndrojnë në mesin e klasës si një statujë e vetme (trupat e vullnetarëve duhet të jenë afër njëri-tjetrit në një lloj formacioni). Udhëzoni ata që të vendosin ndonjë gjë të pazakonshme në trupat e tyre, si p.sh. të varin syzet në vesh, apo të mbajnë unazën në mes të buzëve. U thoni se duhet të qëndrojnë të ngrirë gjatë aktivitetit, mu sikur një statujë.
- Hyni në klasë dhe kërkojuni nxënësve të mbyllin sytë për pak sekonda. Sillni brenda vullnetarët e statujës. Kur vullnetarët të bëjnë statujën, kërkojuni nxënësve tjerë të hapin sytë.
- Tash, pyesni disa nga nxënësit që janë në kënde të ndryshme të klasës që të përgjigjen në



disa pyetje në lidhje me statujën. Për shembull: Sa sy i shihni në statujë? Sa këmbë? Sa gishta janë në duart e djathta?

- Tash, kërkoni nga disa nxënës të qëllojë se çka ka në anët që nuk i shohin të statujës.

- Ftoni nxënësit të ndërrojnë anët, ashtu që të ulen në anët e kundërta nga ku ishin të ulur më parë. Kërkojuni të analizojnë përgjigjet e dhëna më parë. Apo, mund t'ju bëni sërish të njëjtat pyetje.

Reflektimi

- Kërkojuni nxënësve të flasnin për aktivitetin me partnerët e tyre. A i kishin dhënë të gjitha informatat e sakta? A kishin bërë supozime që dolën të jenë të pasakta?

- Pyetni nxënësit pse kishin parë gjëra të ndryshme në aktivitetin me statujë. Përgjithësoni situatën duke i pyetur nëse kishin pasur rast të shikonin ndonjë film apo ndonjë video tjetër së bashku me ndonjë shok dhe, në fund të filmit të ketë ndodhur që secili prej tyre të ketë menduar gjëra të ndryshme në film si të rëndësishme, qesharake, të pikël luara, apo interesante. Pyesni ata si mund të ndodh që dy persona e shohin të njëjtin film dhe e interpretojnë ndryshe.

- Pyesni nxënësit: Pse njerëzit bëjnë supozime? Prej nga vijnë këto supozime?

- Kërkojuni nxënësve të reflektojnë për pyetjen: Si mund të ndikojnë perceptimet tona në gjykimin për njerëzit dhe kulturat tjera?



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

Pajtohesh apo nuk pajtohesh?

- Në katër letra të ndryshme shënoni katër fjalët në vijim: pajtohem plotësisht, pajtohem, nuk pajtohem, aspak nuk pajtohem. Vendosni secilin letër në një kënd të veçantë të klasës.

- Deklaroni çështjen: Mënyra se si i bëj unë gjërat është mënyra më e mirë për t'i bërë ato. U thoni nxënësve të pozicionohen në këndin përkatës varësisht nga sa pajtohen me deklaratën. Kërkojuni nxënësve të krijojnë çifte dhe t'i shpjegojnë njëri-tjetrit arsyet e zgjedhjes së tyre (duke përdorur të dëgjuarit aktiv). Pastaj kërkojuni së paku një nxënësi në secilin kënd të tregojë arsyet për pozicionimin e tillë të çiftit të tyre.

- Tash, u thoni nxënësve se kanë rast të shohin çështjen nga një këndvështrim tjetër. Kërkojuni grupit "Pajtohem plotësisht" të shkojë te këndi "Nuk pajtohem" dhe grupit "Nuk pajtohem" të shkojë te këndi "Pajtohem plotësisht". Pastaj kërkojuni grupit "Aspak nuk pajtohem" të shkojë te këndi "Pajtohem", derisa grupi "Pajtohem" duhet të shkojë te këndi "Aspak nuk pajtohem".

- Pasi të kenë lëvizur nxënësit te këndet e reja, kërkojuni të lënë mënjatë mendimin e tyre të parë, të bëhen hapin mendjen dhe të mendojnë për të gjitha arsyet e mundshme për të marrë këtë pozicion të ri për të njëjtën deklaratë. Pasi të kenë diskutuar nxënësit në dyshe për arsyet e tyre (sërish duke shfrytëzuar të dëgjuarit aktiv), kërkojuni nxënësve nga secili kënd të tregojnë arsyet për pozicionimin e tillë të çiftit të tyre.

Aktivitete pasuese:

- Kërkojuni nxënësve të shkruajnë për përvojën kur dikush ka gjykuar për ta në mënyrë të gabuar dhe për një përvojë kur ata mund të kenë bërë një gjykim të gabuar për dikë tjetër.

Diversiteti: Perceptimet e ndryshme

TITULLI: NJË KORNIZË NUK U
PËRSHTATET TË GJITHA FOTOGRAFIVE?

NIVELI: KLASAT 6 - 9

KOHA: 40 MINUTA

REZULTATET E TË NXËNIT

Rezultatet e të nxënimit

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë domethënien e perceptimeve, supozimeve dhe stereotipeve;
- Interpretojnë sjelljet, adetet, veprimet dhe praktikatat nga më shumë se një këndvështrim;
- Shpjegojnë se si njerëzit e ndryshëm mund të interpretojnë realitetin e njëjtë në mënyra të ndryshme;
- Logjikojnë se kur njerëzit mësojnë për njerëzit dhe kulturat e ndryshme, e bëjnë këtë përmes kornizës së tyre kulturore/personale;
- Kuptojnë se të menduarit e tyre është i ndikuar nga forcat sociale si media, historia dhe idetë egocentrike.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Fotografi të njerëzve që nuk janë të njohur për nxënësit (shembujt janë dhënë në shtojcën 7.1);
- Tabakë letre, markera, ngjytës.

INFORMACIONI PARAPRAK

Qëllimi i kësaj njësie është që të ndihmojë nxënësit të jenë të vetëdijshëm se mund t'i shohim gjërat nga perspektiva apo këndvështrime të ndryshme. Ne, po ashtu duam t'ju demonstrojmë atyre se ne shpesh bëjmë supozime që janë të pasakta, kur shikojmë një gjë vetëm nga një këndvështrim. Nxënësve do t'ju jepet rasti të shqyrtojnë prej nga vijnë stereotipat dhe supozimet e tyre dhe të sfidojnë stereotipat që kanë krijuar.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Mendime të ndryshme

- Kërkojuni nxënësve të qëndrojnë në rreth. Udhëzoni ata se duhet t'i dëgjojnë me kujdes shokët e klasës gjatë këtij aktiviteti.

- Secili nxënës duhet të mendojë për një person të



NXËNËS DUKE VIZATUAR GJATË NJË PUNËTORIE NË PRIZRËN

famshëm. Pasi të kenë menduar për pak sekonda, thoni që secili me radhë duhet të përmend personalitetin që ka zgjedhur.

- Kur secili nxënës të ketë përmendur personin e famshëm, filloni rrethin e dytë. Në këtë rreth, kërkojuni atyre të përmendin personin e zgjedhur nga shoku apo shoqja në të majtë të tyre. Mund të prisni se disa nga ata nuk e kanë mbajtur mend se cili ka qenë personaliteti i shokut apo shoqes në të majtë. Në këto raste, nxënësi në të majtë mund të përmend sërish personalitetin e vet. - Pasi të gjithë të flasin, kërkojuni nxënësve të reflektojnë për larminë e njerëzve të përmendur dhe për llojshmërinë e mendimeve në klasë. Pse ka në klasë preferenca kaq të ndryshme lidhur me personat e famshëm? A është kjo mirë apo keq? Pse?

Aktiviteti kryesor: Kush janë këta njerëz?

- Ndani nxënësit në grupe prej 3 - 5 vetave. Jepni secilit grup një fotografi të personit apo personave që nxënësit nuk do t'i njohin (mund të jenë fotografi të njerëzve të famshëm, por që nxënësit nuk i njohin, apo njerëz jo të famshëm të cilët ju i njihni). Mund të shfrytëzoni fotografitë shembuj që janë dhënë në këtë doracak (shtojca 7.1), apo mund të zgjidhni fotografi tjera që i gjeni si të përshtatshme. Grupet e ndryshme mund të kenë kopje të të njëjtës fotografi. Kjo do t'ju mundësojë që të hapni diskutimin lidhur me këtë në fazën e reflektimit.

- Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për fotografimin brenda grupit të tyre. Secili grup duhet të krijojë një kornizë për personin apo personat e tyre, ngjashëm siç kishin vënë veten në kornizë në njësien e kaluar mësimore. Tregojuni atyre shabllonin (shtojca 6.2) që të mund të bëjnë diçka të ngjashme dhe u thoni që



t'i shkruajnë idetë e tyre në tabakë letre (në formë të pllakateve). Nxitni ata të jenë kreativë dhe të ndjekin idenë e tyre se si ta ndërtojnë kornizën e personit apo personave të tyre. Nxënësit duhet të përqendrohen në jetën personale dhe profesionale të personit apo personave të tyre, duke përfshirë gjendjen ekonomiko-sociale, moshën, edukimin, familjen, etj.

- Pasi grupet të përfundojnë punën e tyre, kërkojuni të varin pllakatet kornizë në mur.

- Kërkojuni nxënësve të ecin përreth dhe të shikojnë të gjithë pllakatet, ose nëse ka kohë, grupet mund të prezantojnë pllakatet kornizë.

- Nxjerr në pah informacionin e vërtetë lidhur me secilin person nëpër fotografi dhe leni pak kohë për nxënësit që ta kuptojnë informatën.

Reflektimi

Ndihmoni nxënësit të shqyrtojnë se prej nga vijnë idetë e tyre për njerëzit tjerë. Pyetjet për t'u pasuar mund të jenë:

- Si dhe pse erdhët deri të informacioni për fotografinë tuaj?

- A ishte ndonjë nga informatat lidhur me fotografinë e bazuar në stereotipe?

- Si mund të shmangim krijimin e supozimeve dhe stereotipave për personat tjerë?

- Nga çka ndërtohen perceptimet tona për njerëzit tjerë në botë?

Pasoni këto dy aktivitete të para më një diskutim në klasë. Udhëhiqni nxënësit drejt vetëdijesimit se asnjëherë dy njerëz nuk e shohin të njëjtën gjë në të njëjtën mënyrë. Të gjithë njerëzit sjellin në situatën aktuale vlerat e veta, bindjet e veta, përvojat e tyre jetësore dhe forcën e tyre të vëzhgimit.



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

Statuja (Shih aktivitetin paraprak)

Skena komplekse

- Përmes projektorit, nëse është e mundur, tregojuni nxënësve një skenë komplekse me shumë gjëra që zhvillohen aty – nga një pikturë, reklamë, libër me ilustrime, apo nga ndonjë burim tjetër. Kjo duhet të jetë një skenë që nxënësit nuk e kanë parë ndonjëherë më parë. Kërkon nga nxënësit që të koncentrohen me kujdes dhe tregojuni atyre këtë skenë për 10 sekonda dhe jo më gjatë. Pastaj pyesni disa nxënës, me radhë, se çka kanë parë. Kërkojuni atyre të jenë specifikë lidhur me detajet dhe pastaj ftoni nxënësit tjerë të ofrojnë atë që kujtojnë apo interpretimet e tyre nëse kanë parë gjëra të tjera. Është e mundur që nxënësit të kenë parë dhe interpretuar detaje të ndryshme – mu sikur se dallojnë në detajet që kanë parë dëshmitarët e krimeve apo aksidenteve.

Aktivitetet pasuese:

- Kërkon nga nxënësit që të marrin një ngjarje botërore aktuale apo një ngjarje historike dhe të shënojnë një artikull mbi ngjarjen apo çështjen prej dy perspektivave, që përfaqësojnë pikëpamje të kundërta apo pikëpamje të vendeve të ndryshme.

- Kërkon nga nxënësit të shkruajnë lidhur me domethënien e këtij citati: Që t'i ikësh keqkuptimit të sjelljes së të tjerëve, duhet të provosh të shohësh botën prej këndvështrimit të tyre, jo prej tëndit.

- Për të përgjithësuar më mirë idenë e perceptimeve të ndryshme mund të organizoni një aktivitet ku nxënësit duhet të mbathin këpucët e moshatarëve të tyre dhe të ecin përreth. Pas disa minutave, mblidhi nxënësit në rreth dhe reflektoni për aktivitetin. Shpjegojuni nxënësve thënien "Të ecësh në këpucët e tjetrit", thënie që njerëzit shpesh e përdorin.

Diversiteti: Respektimi dhe pranimi i ndryshimeve

TITULLI: KOMUNITETI DHE PRANIMI

NIVELI: KLASAT 3 – 6

KOHA: 80 MINUTA (MUND TË NDAHET
NË DY SESIONE TË VEÇANTA)

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë bashkësitë (grupet) e ndryshme të cilave u përkasin;
- Kuptojnë se njerëzit janë të lidhur përmes përvojave dhe interesave të njëjta;
- Pranojnë se ka ndryshime në çdo bashkësi (komunitet) dhe kjo i bën bashkësitë të larmishme (diverse) dhe të shëndetshme;
- Diskutojnë se si është të jesh i përjashtuar nga grupi;
- Gjejnë mënyra se si të jenë më përfshirës.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Letrat ngjitëse (etiketat) duhet të përgatiten që më parë për aktivitetin hyrës
- Një vend i hapur ku nxënësit mund të lëvizin përreth
- Një lëmsh peri
- Kopje të fletës së punës "Grupet të cilave u përkas" për secilin nxënës (shtojca 8.1)

INFORMACIONI PARAPRAK

Kjo njësi mund të ndahet në dy sesione të veçanta, ku nxënësit mund të marrin një pushim pas reflektimit për aktivitetin hyrës.

Aktiviteti i parë ofron mundësi për të parë se çka ndodh kur njerëzit ndihen të përjashtuar prej grupeve dhe i nxit nxënësit të diskutojnë se si të gjithë mund të ndihen të përjashtuar. Aktiviteti kryesor përqendrohet në bashkësitë apo komunitetet të cilave njerëzit i takojnë. Kjo na ndihmon të kuptojmë



se si ne mund të kemi gjëra të përbashkëta me njerëzit nga komunitetet tjera dhe të krijojmë një pranim më të madh për bashkësitë që janë të ndryshme nga ajo e jona.

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Ku përkas unë? Përgatitje para aktivitetit:

- Letrat ngjitëse (etiketat) për aktivitet duhet të përgatiten që më parë. Ju duhet të mendoni për kategori të ndryshme dhe për gjëra që paraqesin secilën kategori. Këtu janë disa shembuj që mund të përdorni:
 - Ngjyrat: e kaltër, e kuqe, e verdhë, kafe
 - Ushqimet: buka, mishi, perimet, frutat, vaji
 - Kafshët: tigri, ariu, qeni, kali
 - Duhet të shënoni një gjë në secilën etiketë. Për shembull në një etiketë duhet të jetë e shënuar fjala "qeni."
 - ME RËNDESI: Në tri apo katër etiketa, duhet të



Kisha
Gjarmva
Qarshia
Ura e Gurit
Lidhja e
Prizrenit

jenë të shkruara gjëra të zakonshme që nuk lidhen me asnjërën kategori, ose shënoni një pikëpyetje në njërën etiketë, lëroni etiketën tjetër të zbrazët, e kështu me radhë. Qëllimi është të krijoni tri apo katër etiketa që nuk i përkasin asnjërit grup.

Aktiviteti:

- Filloni duke iu thënë nxënësve të qëndrojnë në rreth. Thoni se ata duhet të mbyllin sytë. Vendosni një etiketë në ballin e secilit nxënës. Pastaj u thoni atyre se duhet të rrinë të heshtur e të mos flasin gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Më pastaj u thoni nxënësve të hapin sytë, të lëvizin përreth dhe të gjejnë grupin apo bashkësinë të cilës ata mendojnë se i takojnë.
- Ju duhet të rriini mënjanë dhe të shikoni aktivitetin, në mënyrë që të vëzhgoni se si nxënësit po i formojnë grupet dhe ç'po ndodh me nxënësit që nuk kanë grupe. Kjo ju duhet për ta theksuar gjatë reflektimit.

- Jepni shenjë për përfundimin e aktivitetit kur të mendoni se nxënësit nuk kanë ç'të bëjnë më shumë.

Reflektimi

- Sigurohuni që të lini mjaft kohë për nxënësit që të reagojnë ndaj situatës së nxënësve që nuk kanë grupe.
- Mund të filloni duke pyetur:
 - A i takuan të gjithë një bashkësie?
 - Pyesni se si u ndien nxënësit që nuk kishin grup.
 - Pyesni nëse nxënësit nga ndonjë grup tjetër i ftuan të bëhen pjesë e grupit të tyre.
 - Pyesni nxënësit tjerë se çka mund të kishin bërë ata për t'i përfshirë nxënësit që nuk kishin vend ku të shkonin.
 - Kërkoju nxënësve të mendojnë për ndonjë rast kur nuk ishin ftuar në ndonjë grup apo nuk ishin ftuar në një ngjarje pjesë e së cilës donin të bëheshin. Si i kishte bërë kjo të ndiheshin?

Aktiviteti kryesor 1: Rrjeti virtual i bashkësisë

- Kërkoni nga nxënësit të qëndrojnë në rreth.
- U thoni atyre të mendojnë për gjërat që kanë dëshirë t'i bëjnë apo gjërat lidhur me familjen apo jetën e tyre. Kërkojuni të zgjedhin një gjë që është me rëndësi për ta ose pas së cilës janë të pasionuar. Do të kenë mundësinë të zbulojnë nëse dikush tjetër është i ngjashëm me ta. Shembuj të ideve mund të jenë:

- Unë jam nxënës.
- Unë kam dëshirë të luaj më shokë.
- Më pëlqen futboll.
- Unë kënaqem duke mësuar matematikë.
- Unë kam një motër.
- Unë jetoj me gjyshërit e mi.

- Pasi nxënësit të kenë menduar individualisht për diçka, mund të filloni aktivitetin. U thoni nxënësve se duhet të kthejnë deklaratën e tyre në formë pyetjeje në mënyrë që të zbulojnë nëse dikush është i ngjashëm me ta në këtë pikë.

- Filloni aktivitetin me një lëmsh peri në dorën tuaj. Bëni pyetjen e parë, si p.sh. kush ka një motër?

- U thoni nxënësve që kanë motra të ngritin duart e tyre.

- Ju duhet të zgjidhni njërin nga nxënësit që ka ngritur dorën. Pastaj, lidhe skajin e fijes përreth gishtit dhe hedhe lëmshin të ai nxënës. Mbye fijen të tërhequr.

- Pasi që nxënësi të pranojë lëmshin, ai/ajo bën pyetjen e vet dhe pastaj ia gjuan një personi. Sërisht, sigurohuni se nxënësi e lidh fijen përreth gishtit para se ta hedhë lëmshin. Përkujtojuni nxënësve se duhet ta mbajnë fijen të tërhequr.

- U thoni nxënësve se nëse tek ndonjë pyetje e caktuar askush nuk ndihet sikur do ta ngrit dorën, nuk kanë nevojë ta bëjnë këtë. Në këtë rast, nxënësi që e ka lëmshin mund t'ia hedh lëmshin dikujt që nuk e ka pasur deri tash dhe ta pyes: "Pra, çka është me rëndësi për ty... (e përmend emrin e shokut apo shoqes)?" Më tutje, aktiviteti vazhdon sikur kishte filluar. Aktiviteti mbaron kur të gjithë të kenë rastin të shprehën për gjënë e rëndësishme për ta.

- Ideja është të krijohet një rrjet që tregon mënyrat e ndryshme në të cilat jemi të lidhur të gjithë ne.

Aktiviteti kryesor 2: Bashkësitë e mia

- Filloni duke kërkuar nga nxënësit që të mendojnë për pyetjet e ndryshme që u shtruan gjatë aktivitetit me rrjet.

- U thoni atyre se ne shpesh i bashkohemi grupeve duke u bazuar në interesat dhe në stilin e jetesës.

- Jepni secilit nxënës fletën e punës "Grupet të cilave u përkas" (Shtojca 8.1) dhe kërkojuni atyre të zgjedhin të gjitha grupet të cilave u përkasin.

- Pasi nxënësit të plotësojnë fletën e punës, u thoni të krijojnë grupe të vogla dhe të krahasojnë listën e tyre me listën e të tjerëve në grup.



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Nxënësit individualisht apo si klasë mund të bëjnë një plan veprimi që tregon se si mund të parandalohet përjashtimi i njerëzve. Shkruani një parullë për të marrë masa ndaj përjashtimit.
- Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një përkufizim të një "bashkësie të mirë"

- Kërkojini secilit grup të zgjedh një bashkësi të cilën e kanë rrethuar të gjithë brenda grupit (mund të jetë shkolla apo familja).

- Pastaj, si grup, duhet të diskutojnë apo të shkruajnë mënyrat se si bashkësia që kanë zgjedhur, mund të jetë e ngjashme me një bashkësi në një qytet tjetër apo e ngjashme me një grup në një vend tjetër. Nxënësit mund të mendojnë për këtë gjë në këtë mënyrë:



Reflektimi

Pyesni nxënësit se si krijohen bashkësitë/grupet:

- Pse njerëzit u takojnë grupeve të ndryshme?
- Si u ndihmojnë grupet apo bashkësitë anëtarëve të tyre?

- A mund të jenë grupet ndonjëherë të dëmshme? Nëse po, kur e si?

Kërkojini nxënësve të flasin për ngjashmëritë/ndryshimet në komunitete apo bashkësi.

- A ekzistojnë komunitetet shkollore në vendet tjera në Kosovë?

- Si mund të jetë komuniteti juaj e njëjtë sikur një komunitet larg prej jush?

- Cilat janë disa nga ndryshimet në mes të komuniteteve apo bashkësive?

- A mendoni se njerëzit i kanë të njëjtat arsye si ju për t'i takuar një komuniteti?



PUNIME NË NJË VENDNDODHJE TË TRASHËGIMISË, KOSOVË,

Diversiteti: Respektimi dhe pranimi i ndryshimeve

TITULLI: NE TË GJITHË PËRKASIM

NIVELI: KLASAT 6 – 9

KOHA: 80 MINUTA (MUND TË NDAHET
NË DY SESIONE TË VEÇANTA)

REZULTATET E TË NXËNIT

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Zhvillojnë të kuptuarit për bashkësitë (grupet, komunitetet) e ndryshme të cilave u takojnë;
- Kuptojnë se njerëzit janë të lidhur përmes përvojave dhe interesave të njëjta;
- Pranojnë se ka ndryshime në çdo bashkësi (komunitet) dhe kjo i bën bashkësitë të larmishme (diverse) dhe të shëndetshme;
- Diskutojnë së si është të jesh i përjashtuar nga grupi dhe të gjejnë mënyra se si të jenë më përfshirës.

MATERIALET/PËRGATITJET PRAKTIKE

- Një hapësirë e madhe duhet për aktivitetet;
- Letra me ngjyra – një letër e kaltër për secilin nxënës dhe tri letra të verdha për secilin nxënës;
- Spango;
- Gërshërë, markera, ngjites;

INFORMACIONI PARAPRAK

Kjo njësi mund të ndahet në dy sesione. Një kohë e përshtatshme për pushim mund të jetë pas reflektimit për aktivitetin hyrës.

- Aktiviteti i parë ofron mundësi për të parë se çka ndodh kur njerëzit ndihen të përjashtuar prej grupeve dhe i nxit nxënësit të diskutojnë se si të gjithë mund të ndihen të përjashtuar. Pjesa e dytë e njësisë përqendrohet në përkufizimin e bashkësive/komuniteteve dhe në bashkësitë e ndryshme që njerëzit mund t'u takojnë. Ideja është që të kuptojmë lidhjet që njerëzit prej komuniteteve të ndryshme kanë me njëri-tjetrit. Duke shqyrtuar marrëdhëniet, ne mund të ndërtojmë një mirëkuptim më të madh për grupet që janë të ndryshme nga ne, dhe t'i respektojmë e pranojmë ato.



NXËNËS DUKE VIZATUAR GJATË NJË UORKSHOPI, PRIZREN

PROCEDURA

Aktiviteti hyrës: Të ndierit i/e përjashtuar

- Përcaktoni numrin e grupeve që mund të formoni me nga gjashtë apo shtatë nxënës brenda grupit.
- Filloni duke thënë se ju duhen disa vullnetarë. Zgjidhni numër të njëjtë të vullnetarëve me numrin e grupeve që keni përcaktuar më herët (nëse keni 7 grupe, ju duhen 7 vullnetarë).
- U thoni nxënësve të presin për një minutë, deri sa të nxjerrni vullnetarët jashtë në korridor. U thoni vullnetarëve se do t'u ktheheni atyre për t'u dhënë udhëzimet.
- Kthehuni në klasë dhe kërkoni nga nxënësit që të grupohen në grupe prej 5 apo 6 vetave dhe të formojnë rrethe (nuk ka problem nëse ndonjë grup është më i madh apo më të vogël se të tjerët).
- Jepni secilit grup një letër me një numër në të.
- Tregojuni nxënësve se qëllimi i secilit rreth është të mbajnë vullnetarët jashtë grupeve të tyre. Ata duhet të zgjedhin një temë për të biseduar (siç mund të jetë planifikimi i një feste, a i një ngjarje shkollore). Secili grup duhet të duket sikur po kalojnë momente të bukura. Ata mund të shfrytëzojnë çfarëdo mjetesh (përveç dhunës) për të mbajtur vullnetarët jashtë grupit të tyre (nxënësit në grup mund të qëndrojnë shumë afër njëri-tjetrit, të mbajnë duart e lidhura mes veti, t'u kthejnë shpinën vullnetarëve, etj.).



- Lëri grupet të përgatiten dhe kthehuni te vullnetarët. Tregojni vullnetarëve se qëllimi i tyre është të bëhen pjesë e rrethit që ju u caktoni. Caktojini secilit vullnetar një numër dhe u thoni se duhet t'i qasen grupit me të njëjtin numër. Rikujtojuni atyre se qëllimi i tyre është bëhen pjesë e grupit. Mos u tregoni se grupi i tyre do të rezistojë. Ata do të kuptojnë këtë vet, më vonë.

- Sillni vullnetarët brenda në klasë dhe jepuni nxënësve kohë për të ndërvepruar. Ju duhet të jeni të vetëdijshëm për taktikat që përdorin grupet për të përjashtuar vullnetarët.

- Pasi nxënësit të kenë marrë pjesë në aktivitet për pak kohë, kërkojuni të kthehen në karriget e tyre.

Reflektimi

Udhëhiqni diskutimin për këtë aktivitet duke i pyetur vullnetarët:

- Si u ndiet duke qenë të përjashtuar?
- Sa u përpoqët ju të jeni pjesë e grupit?
- Çka ju thanë anëtarët e grupit për t'ju mbajtur jashtë grupit?

Pyesni anëtarët e grupit:

- Si u ndiet lidhur me përjashtimin e vullnetarit?
- Sa larg ishit të gatshëm të shkonit, për të mbajtur vullnetarin jashtë grupit?
- U thoni atyre se në situatën e dhënë atyre iu

kërkua që të përjashtojnë dikë nga grupi, por në jetën reale njerëzit përjashtohen sepse konsiderohet se ata dallojnë nga anëtarët e grupit. Kërkojuni nxënësve të reflektojnë dhe të komentojnë për pyetjet në vijim:

- A mund të kujtoni ndonjë rast kur jeni ndier i ndryshëm nga të tjerët? Cila është fjala që më së miri e përshkruan gjendjen tuaj në momentet kur jeni ndier ndryshe? (Ju mund të shkruani këto fjalë në tabelë).

- A jeni përjashtuar ndonjëherë nga grupi të cilit donit t'i bashkoheni? Në çfarë forme ju kanë përjashtuar?

- Çka mund të bëjmë për të parandaluar situatat kur njerëzit ndihen të përjashtuar?

- Kërkojuni nxënësve të mendojnë për një person që është i ndryshëm nga ata. Jepuni atyre disa minuta për ta krijuar imazhin e këtij personi në kokat e tyre. Kërkojuni që të ngritin duart kur të kenë këtë person në mendje. Tash vjen pjesa më e vështirë. Kërkojuni nxënësve të gjejnë së paku dy mënyra në të cilat ky person është i ngjashëm me ta (Ju mund t'u thoni që të ndajnë mendimet e tyre me partnerin afër, nëse duan). Vëni në spikamë para nxënësve se të gjithë ne jemi individë unikë e të ndryshëm nga të tjerët, por prapë se prapë kemi shumë ngjashmëri mes vete.

Aktiviteti kryesor 1: Të shikuarit e ngjashmërive në grupe

- Ju do të shfrytëzoni katër kënde apo hapësira të veçanta të klasës gjatë aktivitetit (nëse i keni në dispozicion vetëm tri hapësira të veçanta, edhe kjo mund të funksionojë).

- Bëjuni nxënësve një pyetje të thjeshtë dhe jepuni katër përgjigje të mundshme.

- Vendosni nga një përgjigje në secilin kënd (apo hapësirë) të klasës.

- U thoni nxënësve të shkojnë te këndi që përfaqëson përgjigjen e tyre.

- Shembull: "Cilën frutë do ta preferonit: mollën, bananen, dardhën, apo qershinë? Një kënd është për mollën; një për bananen; një për dardhën; një për qershinë. Nxënësit duhet të zgjedhin mes këtyre katër këndeve dhe të qëndrojnë te këndi që përfaqëson frutën që zgjedhën.

- Kur të gjithë nxënësit të kenë zgjedhur përgjigjen dhe të qëndrojnë në këndet që paraqesin përgjigjet e tyre, duhet të jenë katër grupe të vogla.

- Në këto grupe të vogla nxënësit duhet të bisedojnë për arsyet që zgjedhën këtë përgjigje.

- Nxënësit do të jenë në gjendje të shohin se në secilin grup nxënësit kanë gjëra të përbashkëta me nxënësit tjerë. Shembull: në grupin e mollëve, secili në grup preferon mollën.

- Detyra e fundit për nxënësit do të jetë që në secilin grup nxënësit të gjejnë së paku edhe një gjë të përbashkët për të gjithë në grup. Për shembull, në grupin e mollës, mund të ndodh se ata të zbulojnë se të gjithë preferojnë të shikojnë televizorin.

Pyetjet shtesë të mundshme:

Cila është stina e juaja e preferuar: pranvera, vera, vjeshta, apo dimri?

Cilën nga këto kafshë të egra e preferoni më së shumti: luanin, elefantin, gorillën, apo ariun polar?

Aktiviteti kryesor 2: Rrjetet e bashkësive

- Filloni duke iu kërkuar nxënësve të përcaktojnë fjalën bashkësi/komunitet.

- Kërkojuni nxënësve (si klasë apo në grupe të vogla) të dalin me një listë të elementeve të përbashkëta që bashkësitë mund t'i kenë. Këto elemente mund të jenë:

- gjuha;
- territori
- marrëdhëniet familjare
- religjioni
- interesat si sporti, hobi
- karakteristikat fizike

U thoni nxënësve se do të krijojnë rrjetet e bashkësisë së klasës, duke shfrytëzuar bashkësitë apo grupet të cilave iu përkasin.



- Jepni secilit nxënës një letër të kaltër dhe tri letra të verdha.

- U thoni atyre të shkruajnë emrin e tyre në letrën e kaltër

- Në secilën nga letrat e verdha, nxënësit duhet shkruajnë nga një komunitet të cilit u takojnë. Mundohuni t'i bindni që të mendojnë për komunitetet të cilave u takojnë në nivelin lokal, nacional dhe global.

- U thoni që të varin emrat e tyre diku në mesin e njërit nga muret.

- Pastaj, u thoni të varin komunitetet e tyre përreth emrit të tyre. Udhëzoni që të varin bashkësinë e tyre më të afërt (lokale) më së afërmi emrit të tyre.

- Afrojuni nxënësve spango. U thoni të prenë spangon dhe të lidhin emrat e tyre dhe bashkësitë e tyre me spango, ashtu që të krijojnë një rrjet. Kërkojuni nxënësve të shikojnë në punën e të tjerëve dhe të shohin nëse aty ka bashkësi tjera të cilave ata



KËSHILLA PËR MËSIMDHËNËSIT

Variantet e aktiviteteve:

- Kërkoni nga nxënësit të përgatisin një dramë për një situatë kur dikush është i përjashtuar. Nxitni ata që ta luajnë këtë dramë dhe pastaj të diskutojnë me klasën për gjërat që mund t'i bëjnë apo t'i thonë nëse shohin se dikush po neglizhohet/përjashtohet nga një person apo grup tjetër. Cili do të ishte reagimi i mundshëm ndaj këtij veprimi?

- Duke u mbështetur në aktivitetin e rrjetit të bashkësive, nxënësit mund t'i shfrytëzojnë fotografitë aktuale nga bashkësitë e tyre. Atyre mund t'u caktohet të dalin në rrethinën e tyre dhe të shohin grupet e ndryshme. Pastaj mund të raportojnë në klasë për këtë.

- Shtyni nxënësit të prezantojnë për bashkësitë/grupet që ata u përkasin, duke u përqendruar në idetë në vazhdim:

- Cili është emri i grupit?
- Qëllimet e atij grupi (pse ekziston grupi);
- Bindjet e atij grupi;
- Rregullat e atij grupi;
- A është anëtarësimi në grup i obligueshëm apo vullnetar?
- A mendoni se ky lloj grupi ekziston në pjesë tjera të botës? Nëse po, si?

u përkasin. Nëse ka bashkësi të cilave u përkasin, ata mund të lidhin emrin e tyre me ato bashkësi përmes spangos.



Reflektimi

Bisedoni me nxënësit se si njerëzit janë pjesë e shumë bashkësive të ndryshme. Ndihmohuni nxënësve të kuptojnë se njerëzit mund të jenë pjesë e grupeve në nivel lokal, nacional dhe global. Theksoni faktin se njerëzit janë pjesë e shumë grupeve të ndryshme dhe

se shpesh mund të kemi ngjashmëri edhe me njerëzit që nuk i njohim fare.

Ndihmohuni nxënësve të mendojnë se si një nxënësit në një pjesë tjetër të botës mund të jenë të ngjashëm dhe të ndryshëm me ta. Çfarë lloji të bashkësive mund t'u takojnë ata? Si mund të jetë bashkësia juaj e ngjashme me një bashkësi diku larg?

Fjalori i termave

KULTURË: Një sistem i besimeve, vlerave dhe supozimeve për jetën që udhëheqin sjelljet dhe janë të përbashkëta për një grup njerëzish. Këtu përfshihen zakonet, gjuha dhe artefaktet materiale. Këto kalojnë prej një gjenerate në tjetrën, shumë rrallë përmes porosive eksplicite.

TRADITË: Besimet apo zakonet që ruhen prej gjenerate në gjeneratë.

BASHKËSIA/KOMUNITETI: Një grup i njerëzve që kanë interesa, bindje dhe/apo formim kulturor të përbashkët.

BESIME/BINDJE: Idetë dhe këndvështrimet që dikush i konsideron si të vërteta.

SJELLJE: Veprimet e vëzhgueshme.

ARTIFAKTE: Materialet që paraqesin aspekte të kulturës njerëzore.

NDËRKULTUROR: I kulturave të ndryshme; që i referohet, përfshin dhe përfaqëson kultura të ndryshme.

NDËRKULTURALIZËM: Shkëmbimet mes grupeve kulturore brenda një shoqërie; mësimi i ndërsjellë ndërmjet kulturave më qëllim që të promovimit të mirëkuptimit, barazisë, harmonisë dhe drejtësisë në një shoqëri të larmishme (diverse).

MULTIKULTURALIZËM: Vlerësim, pranim dhe promovim i kulturave të shumta në një vend; pikëpamja se kulturat e ndryshme në një shoqëri meritojnë respekt të njëjtë.

TRASHËGIMI: Diçka që kalon në një gjeneratë prej gjeneratave paraardhëse

TRASHËGIMI KULTURORE: Tërësia e artefakteve materiale dhe atributëve jo materiale të një grupi apo shoqërie që trashëgohen prej gjeneratave të kaluara, që mirëmbahet nga gjenerata aktuale për t'u dhuruar në të mirë të gjeneratave të ardhshme

TRASHËGIMI KULTURORE MATERIALE/E

PREKSHME: Prona e luajtshme apo e paluajtshme që është e një rëndësie të madhe për trashëgiminë kulturore të njerëzimit, siç janë ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat, veprat e artit dhe artefaktet.

TRASHËGIMI KULTURORE JO MATERIALE/ E

PAPREKSHME: Praktikant, paraqitjet, shprehjet, ashtu sikur se edhe dijet dhe shkathhtësitë (përfshirë instrumentet, objektet, artefaktet, hapësirat kulturore) që bashkësitë/komunitetet, grupet dhe, në disa raste edhe individët i pranojnë si pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore.

PEIZAZH: Një hapësirë që ndijohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimit të natyrës (elementet karakteristike të maleve, lumenjve, luginave, etj)

PEIZAZH KULTUROR: Një hapësirë që ndijohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i ndërveprimit të natyrës dhe faktorit njeri (toka e kultivuar, parqet, dekorimet nëpër shpella, etj.)

DIVERSITET/LARMI:

Gjendje e të pasurit apo e të qenit e përbërë prej elementeve të ndryshme; shumëllojshmëri.

DIVERSITET KULTUROR: Një vend ku janë më shumë kultura që jetojnë së bashku në harmoni; një bashkësi apo hapësirë që përfshin njerëz prej kulturave dhe formimeve të ndryshme.

ANTROPOLOGJI: Një disiplinë shkencore që studion origjinën, sjelljet dhe zhvillimin fizik, shoqëror dhe kulturor të njerëzve

ANTROPOLOG: Shkencëtar social që specializohet në antropologji

ARKEOLOGJI: Studimi sistematik i jetës dhe kulturës njerëzore në të kaluarën, përmes gjetjes dhe ekzaminimit të fakteve materiale të mbetura, siç janë varrezat, ndërtesat, veglat, qeramika, etj.

ARKEOLOG: Një antropolog që studion njerëzit parahistorikë dhe kulturën e tyre.

RUAJTJE: Veprimi apo procesi i ruajtjes, apo i sigurimit; gjendja e të qenit i/e ruajtur, apo e mbajtur larg dëmtimeve, shkatërrimit apo kalbjes; siguri; si: ruajtja e jetës, e bimëve, etj., apo një fotografi e ruajtur mirë.

RUAJTJE E TRASHËGIMISË KULTURORE: Veprimi i aktorëve socialë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore

RESTAURIM: Rivendosja në pozitën apo rangun e mëparshëm; kthimi i humbjeve, dëmtimeve, etj; kthimi apo sjellja në gjendjen paraprake, normale apo të padëmtuar.

RESTAURIM I TRASHËGIMISË KULTURORE:
Veprimi i ndërmarrë në restaurimin e vendeve, objekteve, artefakteve të trashëgimisë kulturore

MBROJTJE: Veprimi i të mbrojturit të dikujt a diçkaje

MBROJTJE E TRASHËGIMISË KULTURORE:
Instrumentet ndërkombëtare dhe nacionale që mbrojnë trashëgiminë kulturore

RITUAL: Ceremoni religjioze apo solemne që përbëhet nga një seri e veprimeve që ndërmerren sipas një rregulli të porositur.

IDENTITET: Fakti i të qenit kush apo çka është një person apo send; karakteristikat që e përcaktojnë këtë.

EMPATI/NDJESHMËRI: Mundësia për të kuptuar, për të qenë i vetëdijshëm dhe i ndjeshëm ndaj ndjenjave (si trishtimi apo gëzimi) të provuara nga një person tjetër

QËNDRIME: Një mënyrë e qëndrueshme e të menduarit apo të ndjerit, e reflektuar në mënyrë tipike përmes sjelljeve të personit

STEREOTIPI: Imazhi apo ideja e manifestuar gjerësisht, por që është e fiksuar apo e thjeshtuar tej mase, lidhur me një lloj personi apo një gjëje; cilësitë që u vihen grupeve të njerëzve lidhur me racën, nacionalitetin, orientimin seksual, etj., të tyre.

PARAGJYKIM: Një mendim apo ndjenjë e papërshtatshme e formuar që më parë apo pa pasur dijeni, vëmendje apo arsye.

DISKRIMINIM: Trajtimi i padrejtë apo paragjykes ndaj kategorive të ndryshme të njerëzve apo gjërave, e bazuar në racë, moshë, gjini, etj. Trajtimi i një grupi të veçantë të njerëzve më keq se të tjerët për shkak të origjinës së tyre racore, nacionale, apo etnike.

TOLERANCË: Aftësia dhe gatishmëria për të toleruar diçka, në veçanti mendimet dhe sjelljet e tjetrit që nuk miratohen medoemos; Mundësia e pranimit dhe respektimit të bindjeve apo praktikave të të tjerëve.

RESPEKT: Ndjenjë pozitive e respektit për një person apo entitet tjetër (si komb apo religjion), dhe po ashtu veprimet dhe sjelljet specifike që përfaqësojnë këtë respekt


PERCEPTIME: Proces përmes të cilit njerëzit i përkthejnë sinjalet shqisore në pikëpamje logjike dhe të uniformuara për botën përreth tyre.




Shtojcat



Shtojca 1.1 – FOTO E HARTËS SË BOTËS PËR AKTIVITETIN “COPEZAT E BOTËS”





1. STILET E VESHJTES

10. MËNJËRAT E PËRSHËNDETJES SË NJERËZVE

2. ARTET (PIKTURAT, LETËRSIA, ETJ.)

11. BINDJET PËR PËRSGJESITË E FËMIJËVE
DHE TË RINJVE

3. MUZIKA DHE VALLET

12. ZAKONET DHE FESTIVET E FESTAVE

4. RËNDËSIA E RELIGJONIT/RITUALEVE
RELIGJIOZE

13. USHQIMET

5. ARKITEKTURA

14. ETIKA NË PUNË

6. ROLI I FAMILJES

15. QËNDRIMI NDAJ MASHËS

7. MIKPRITJA

16. NATYRA E MËDËSISË





8. QËNDRIMI NDAJ KAFSHËVE TË SHTËRISË

17. PËRPARJET E PËRSGJITHSHME PËR BOTËN




9. СТУДИА

18. QËNDRIMI NDAJ HAPËSIRËS PERSONALE/
ИНТИМИТЕТТ

FOTOAlbumi™



FOTOAlbumi™



NJË ANEKDOTË

NASTRADINI SHKOI TE NJI GRUE ATY NË MAHALLË DHE I LYPI KAZANIN E PETKAVE:

- MA EP NJI ÇIKË AT KAZANIN TAT, - I THA, - SE DESHTA ME LA DO PETKA; SAT Ë MBATOJ PUNË, TA BIE SHPEJT, NUK TA VONOT.

EDHE AJO JA DHA.

KUR JA KTHEU NASTRADINI NË NESRET, KISHTE FUTË EDHE NJË KUSI TË VOGËL NË KAZAN.

KUR E PA E ZONJA E KAZANIT, E PYETI:

- Ç'ASHT KJO BARKAÇE KTU, O NASTRADIN?

- Ë KA PJELL KAZANI I JOT, - I THA NASTRADINI.

ASAJ JU BA QEFI FORT DHE E MVER ME GJITHË KUSI.

MBAS DISA DITSH NASTRADINI SHKOI E JA LYPI PRAPË KAZANIN. AJO JA DHA ME GJITHË QEF, TU KUTTUE SE DO T'I PILLTE PRAPË NDOJTI SEND. MIRËPO, KALOI DO KOHË E NASTRADINI S'JA ÇOI KAZANIN. ATËHERE AJO ERDHI DHE JA LYPI VETË NASTRADINIT.

- NASTRADIN, ERDHA ME E MARRË AT KAZANIN, SE M'DUHET TASH.

- COFI KAZANI! - THA NASTRADINI.

- SI COFI KAZANI?! - THA AJO.

- EPO, JA, COFI!

PUNA SHKOI NË GJYGJ.

-KADI EFENDI, - I THA NASTRADINI, - NJI GJA QË PJELL, A COF?

- PO, - JU PËRGJEGJ KADIV - S'DON MEND KJO PUNË!

-PYETNIE, PRA, KËT GRUE, A KA PJELLË KAZANI I SAJ?

- PO, - THA AJO, - KISHTE PJELLË NJI KUSI, NJI BARKAÇE TË VOGËL.

-MIRË PRA, - THA KADIV, - MBASI PASKA PJELLË NJI HERË, PASKA COFË VËRTET TASH!

ANEKDOTA ËSHTË MBLEDHUR NË SHKODËR

MARRË NGA:

ANEKDOTA SHQIPTARE

SHTËPIA BOTUESE EUGEN, TIRANË 2001








TABELA ME ARTIFAKTE

Emri i gjësendit	Prej çfarë materiali përbëhet gjësendi	Për çfarë qëllimi shërben gjësendi?	Çka tregon gjësendi për kulturën?

KUSH JAM UNË?

CILAT JANË FJALËT QË MË PËRSHKRUAJNË MUA?

ÇKA MUND TË BËJ MIRË UNË?

ÇKA MË PËLQEN TË BËJ PËR ARGËTIM?

ÇFARË NDJENJASH KAM?


ÇKA MË INTERESON MË SË SHUMTI?

CILAT JANË NEVOJAT E MIA TË PASHTYESHME?

KU JETOJ UNË

CILAVE GRUPE U TAKOJ UNË?

ÇKA TJETËR MUND TË TREGOJ PËR VETEN?




1.



2.



3.



4.



1. DILMA ROUSSEFF (GRUAJA NË TË MAJTË)

- FEMRA E PARË PRESIDENTE E BRAZILIT
- I ATI I SAJ ISHTE NJË EMIGRANT BULLGAR DHE E ËMA NJË MËSHVESE BRAZILIANE
- EKONOMISTE ME PROFESION
- KA NJË VAJZË NGA NJË MARTESË QË PËRFUNDON ME SHKURORËZIM
- ISHTE E BURGOSUR POLITIKE GJATË VITEVE 1970 – 1977

3. CHRIS GARDNER

- SIPËRMARRËS, INVESTITOR, AGJENT BURSASH, DORATOR MOTIVUES DHE FILANTROP AMERIKAN.
- GJATË VITEVE TË HERSHME '80, LUFTONTE ME VARRFËRINË DERISA RRISTE BIRIN E TIJ TË VOÇËL
- LIBRI I TIJ BIOGRAFIK "KËRKIMI I LUMTURISË" U PUBLIKUA MË 2006
- FILMI ME TË NJËTTIN TTULL, ME AKTORIN WILL SMITH, U SHFAQ TË NJËTTIN VIT.

2. SARI DHE FRESKU

- U TAKUAN NË TERENIN E TENISIT NË PRISHTINË VERËN E KALVAR DHE U BËN SHOKË.
- DITALI ME FLOKË TË SHKURTË ËSHTË SARI. AI DHE E ËMA E TIJ JANË IZRAELITË ME PRËSTARDHJE SHQIPTARE. SARI FLET VETËM PAK FJALË SHQIP.
- FRESKU, DITALI ME FLOKË TË GJATA ËSHTË LINDUR NË GJAKOVË DHE JETON NË PRISHTINË.
- TË DY FËMIJËT JANË RRETHI MOSHËS 7 VJEÇARE DHE TË DY USHTROJNË TENIS.

4. RIGOBERTA MENCHU TUM

- E LINDUR NË NJË FAMILJE TË VARRFËR FSHATARE INDIANE DHE E RRIATUR NË DEGËN QUVICHE TË KULTURËS MAYA.
- NË MOSHËN E SAJ TË RE AJTO KA PUNUAR NË PLANTACIONET E KAFESË.
- FAMILJA E SAJ ISHTE VIKTIMITZUAR PËR SHKAK TË ANGAZHIMEVE POLITIKE.
- AJTO MORI ÇMIMIN NOBEL PËR PAQE MË 1992 PËR HIR TË PUNËS SË SAJ NË DREJTËSINË SHQËRËRE DHE PASTIMIN ETNOKULTUROR TË BAZUAR NË RESPEKTIN PËR TË DREJTAT E NJERËZVE INDIJENË.

GRUPET TË CILAVE U PËRKAS

RRETHOJI GRUPET TË CILAVE U PËRKET

Shkolla

Kisha

Shoqata e skautëve

Grupi i këngëtarëve apo kori

Familja

Unioni studentor

Klubet

Ekipet sportive

Bandë ose orkestër muzikore

Lagje

Tjetër




OPERA KUWAVU, KINË



KËNCË TEATRALE TRADITIONALE KOREANE



MËSIM NË AMBIENT TË HAPUR, NEPAL



NDËRTESË DËRPIÇI NË DËSHINË MALI



MOLI I VETËR NË BERGEN, NORVEGI



HAËSHIË KULTURORE NË SHESHIN TEMAA EL-FUA, MAROKO



GEORGIAN POLYPHONIC SINGING, GEORGIA



MUZIKË E BASHKË TRADITIONALE TË KOMUNITETIT TOSBANA, BREGU I FILDISHITË



UJËVARAT IGUAZU



PUDET TROPICALE TË BRESIT TË SHIRAVE NË AMAZONË



ISHULLI JEJU



SHIRI HALONG



MALI REAFSHIMALË NË KESTRAUN




PARKU NACIONALI KOMODA



LUMI NËJTAKËSOR POKAPRINCESA



UTËVARAT E MIRUSHËS



GRYKA E RUGOVËS



BREZOVICA



SHPELLA E GANIMËS



KANIONI I DRINITË BARDHË



BURIMI I DRINITË BARDHË



BIFURKACIONI I NERODIMES